

Mentorimi i Viktimave Të Trafikimit

Udhëzues riintegrimi për profesionistët



Ky Udhëzues Riintegrimit u përgatit nga Instituti NEXUS dhe “Të Ndryshëm & Të Barabartë” (D&E), në kuadër të projektit: Ofrimi i shërbimeve riintegruese gjithëpërfshirëse dhe përmirësimi i kuadrit të mbrojtjes për viktimat e trafikimit në Shqipëri. Ai është pjesë e një serie udhëzuesish riintegrimit të hartuar për të mbështetur punën e profesionistëve të riintegrimit në Shqipëri, si dhe të profesionistëve nga vendet dhe rajonet e tjera.

Autore: Rebecca Surtees
Kontribues: Mariana Meshi, Stela Tanellari, Adelajda Alikaj
Faqesja dhe dizajni: Laura S. Johnson
Ilustrim: Viktimat e trafikimit të asistuar nga “Të Ndryshëm & Të Barabartë”

Citim i sugjeruar: Surtees, R., M. Meshi, S. Tanellari and A. Alikaj (2022) *Mentorimi i viktimave të trafikimit. Një guidë riintegrimit për profesionistët*. Tiranë: Të Ndryshëm & Të Barabartë dhe Washington, D.C.: NEXUS Institute.

© 2021 Të Ndryshëm & Të Barabartë (D&E) dhe Instituti NEXUS

Të Ndryshëm & Të Barabartë (D&E) është një organizatë jofitimprurëse e përkushtuar për të dhënë shërbime cilësore për mbrojtjen dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit, shfrytëzimit dhe abuzimit, dhe për të ndryshuar kontekstin ligjor, institucional dhe social për të luftuar këto abuzime. Aktivitetet kryesore të D&E përfshijnë: identifikimin dhe referimin e viktimave; ofrimin e shërbimeve gjithëpërfshirëse, afatgjata të riintegrimit (rezidenciale dhe komunitare); ndërgjegjësimin e komuniteteve për trafikimin e personave dhe për të drejtat e viktimave të trafikimit; parandalimin e trafikimit nëpërmjet mbështetjes së grupeve të cënueshme; trajnimin dhe ngritjen e kapaciteteve të partnerëve shtetërorë dhe të shoqërisë civile; studime dhe vlerësime; asistencë teknike në hartimin e ligjeve dhe legjislacionit për mbrojtjen e viktimave të trafikimit; dhe advokimin për të drejtat dhe mbrojtjen për viktimat e trafikimit.

www.differentandequal.org

[@DifferentEqual](https://twitter.com/DifferentEqual)



Instituti NEXUS® është një qendër e pavarur ndërkombëtare për kërkime dhe politika mbi të drejtat e njeriut. NEXUS i dedikohet dhënies fund të formave bashkëkohore të skllavërisë dhe trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe abuzimeve dhe veprave të tjera penale që ndërthurin të drejtat e njeriut dhe politikatat e të drejtën penale ndërkombëtare. NEXUS është lider në kërkime, analiza, vlerësime dhe asistencë teknike, dhe në zhvillimin e qasjeve novatore për të luftuar trafikimin e qenieve njerëzore dhe problematika lidhur me të.



www.NEXUSInstitute.net



[@NEXUSInstitute](https://twitter.com/NEXUSInstitute)







“Së bashku - Krah për krah”

Këshillat, fjalët e mira dhe energjia pozitive, mjaftojnë për t’u ndjerë mirë dhe për të qenë pozitivë me veten.

*Ilustrim dhe citim nga
viktimë e trafikimit e asistuar nga
Të Ndryshëm dhe Të Barabartë
(D&E)*

Tabela e përmbajtjes

| | |
|---|-----------|
| Rreth udhëzuesit të riintegritimit | 1 |
| Çfarë është ky udhëzues | 1 |
| Audienca e synuar..... | 1 |
| Si ta përdorim këtë udhëzues..... | 2 |
| Të kuptuarit e procesit të riintegritimit të viktimave të trafikimit | 3 |
| Korniza e riintegritimit..... | 3 |
| Tre fazat e riintegritimit | 9 |
| Pengesat dhe sfidat e riintegritimit | 10 |
| Mentorimi i viktimave të trafikimit. Një model për riintegrimin..... | 12 |
| Çfarë është mentorimi?..... | 12 |
| Karakteristikat e mentorëve | 13 |
| Roli i mentorëve në rikuperimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit | 16 |
| Mentorimi gjatë riintegritimit të viktimave të trafikimit | 16 |
| Modele të ndryshme mentorimi – mentorë dhe mentorë ish viktimave..... | 18 |
| Puna me viktimat e trafikimit - mentorët dhe profesionistët e riintegritimit..... | 20 |
| Menaxherët e rasteve dhe profesionistët multidisiplinarë | 20 |
| Mentorët dhe marrëdhëniet e tyre me profesionistët e riintegritimit | 21 |
| Supervizimi dhe kujdesi për veten..... | 23 |
| Krijimi i marrëdhënies së mentorimit | 24 |
| Identifikimi i të mentoruarve..... | 24 |
| Përzgjedhja e mentorëve | 25 |
| Përgatitja e mentorëve | 26 |
| Përputhja midis mentorëve dhe të mentoruarve | 27 |
| Menaxhimi i marrëdhënies së mentorimit | 28 |
| Fazat e ndryshme të marrëdhënies së mentorimit | 30 |
|  Faza #1. Ndërtimi i marrëdhënies mentor - i/e mentoruar (1 muaj) | 30 |
|  Faza #2. Shkëmbimi i përvojave dhe vendosja e qëllimeve (1-2 muaj) | 31 |
|  Faza #3. Puna drejt qëllimeve dhe thellimi i angazhimit (afërsisht 9 muaj) | 33 |
|  Faza #4. Përfundimi i marrëdhënies formale të mentorimit dhe planifikimi për të ardhmen (1-2 muaj)..... | 35 |
| Sfidat që hasen në mentorimin e viktimave të trafikimit gjatë riintegritimit | 37 |
| Koha dhe energjia e kufizuar | 37 |
| Çështje të besimit dhe sigurisë | 37 |
| Kur nuk ka një përgjigje | 38 |
| Të qenit të ndërjegjshëm për ngjashmëritë dhe dallimet..... | 38 |
| Sjelljet lënduese | 38 |

| | |
|---|-----------|
| Bërja e kërkesave dhe vendosja e kufijve | 38 |
| Rregulla të thyera | 39 |
| Ndjenjat e inferioritetit | 39 |
| Gjetja e aktiviteteve të dhura | 39 |
| Ndjekja e planit | 39 |
| Mentorimi – një model i ri | 39 |
| Udhëzime për profesionistët..... | 40 |
| Shtojcat | 43 |
| Shtojca #1. Fjalorth i termave | 44 |
| Shtojca #2. Studime dhe burime për riintegrimin nga D&E dhe NEXUS Institute..... | 46 |

Rreth udhëzuesit të riintegrimit



Çfarë është ky udhëzues

Rikuperimi dhe riintegrimi pas një përvoje trafikimi është një proces i vështirë dhe i ndërlikuar që përfshin sfida të konsiderueshme për viktimat, si dhe për pjesëtarët e familjeve të tyre, dhe mjediset familjare dhe komunitare ku ata do të riintegrohen. Ofruesit e shërbimeve luajnë një rol të rëndësishëm dhe ndonjëherë jetë ndryshues në mbështetjen e viktimave të trafikimit gjatë procesit të riintegrimit. Midis këtyre profesionistëve ka mentorë që luajnë një rol të rëndësishëm në ofrimin e mbështetjes emocionale dhe sociale të viktimave të trafikimit, si dhe një model pozitiv dhe shembull të një marrëdhënieje të shëndetshme dhe mbështetëse. Mentorët gjithashtu punojnë me viktimat e trafikimit për të ndërtuar marrëdhënie besimi dhe për të shmangur marrëdhëniet e dëmshme.

Ky udhëzues riintegrimit i pajis profesionistët me informacionin rreth modeleve për mentorimin e viktimave të trafikimit gjatë procesit të riintegrimit. Udhëzuesi fillon me një përmbledhje të procesit të rikuperimit dhe riintegrimit pas një përvoje trafikimi. Më pas, ai shpjegon modelin e mentorimit dhe rolin e mentorëve, krahas atij të profesionistëve të tjerë, në mbështetjen e riintegrimit. Ai gjithashtu shpjegon hap pas hapi krijimin e marrëdhënies së mentorimit, përshkruan fazat e ndryshme në të cilat kalon procesi i mentorimit dhe sfidat e kësaj marrëdhënie. Udhëzuesi përfundon me udhëzimet për mentorët dhe profesionistët e riintegrimit kur përdorin këtë model për të mbështetur riintegrimin e viktimave të trafikimit.

Ky udhëzues riintegrimit bazohet në përvojën e D&E në hartimin dhe zbatimin e modeleve të ndryshme të mentorimit për të mbështetur viktimat e trafikimit gjatë riintegrimit të tyre. Udhëzuesi përfshin gjithashtu përvojat e jetës reale dhe reflektimet e viktimave të trafikimit që kanë qenë të përfshira në këto programe mentorimi.



Audienca e synuar e këtij udhëzuesi

Ky udhëzues është me vlerë për profesionistët që punojnë në rikuperimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit të të rriturve dhe fëmijëve në Shqipëri si dhe në fusha të tjera. Ky është një material i një rëndësie të veçantë për personate angazhuar si mentorë të viktimave të trafikimit. Por është gjithashtu i dobishëm për profesionistët që punojnë së bashku me mentorët në procesin e riintegrimit, duke përfshirë punonjësit socialë, psikologët dhe këshilluesit, profesionistët e kujdesit shëndetësor, avokatët dhe juristët, stafin arsimor (mësuesit, drejtorët, psikologët e shkollave), punonjësit për mbrojtjen e fëmijëve, administratorët social dhe profesionistët që punojnë për fuqizimin ekonomik dhe në sektorin e punësimit.

Si ta përdorim këtë udhëzues

Ky udhëzues riintegrimi është një burim praktik për mentorët dhe profesionistët e riintegrit, të cilët mund ta përdorin në punën e tyre të përditshme në ofrimin e shërbimeve riintegruese apo të mentorimit. Ai mund të përdoret për të përgatitur dhe trajnuar profesionistë, si dhe për referim gjatë punës së vazhdueshme të riintegrit.

Ai është pjesë e një serie udhëzuesish riintegrit që shqyrtojnë aspekte të ndryshme të rikuperimit dhe riintegrit, dhe që shpjegojnë dhe ofrojnë udhëzime se si mund të adresohen çështje dhe pengesa kryesore në riintegritin e viktimave të trafikimit. Profesionistët e riintegrit duhet t'iu referohen udhëzuesve përkatës kur kryejnë punën e tyre me viktimat e trafikimit. Kjo seri përfshin tre udhëzues riintegrit për aspekte të ndryshme të rikuperimit dhe riintegrit, duke përfshirë:

- Fazat e rikuperimit dhe riintegrit të viktimave të trafikimit
- Mbështetja e fëmijëve të viktimave të trafikimit
- Mentorimi i viktimave të trafikimit


Kjo seri udhëzuesish riintegrit për profesionistët është hartuar nga Të Ndryshëm & Të Barabartë(D&E) dhe Instituti NEXUS.

Të kuptuarit e procesit të riintegrit të viktimave të trafikimit¹

Korniza e riintegrit

Trafikimi ka ndikime shumë serioze në mirëqenien fizike, psikologjike, ekonomike dhe sociale të viktimave të trafikimit. Përveç kësaj, shumë viktima të trafikimit janë përballur me probleme në jetën e tyre përpara trafikimit, të cilat vazhdojnë edhe pas trafikimit. Probleme të tjera gjithashtu shfaqen përgjithësisht në jetën dhe marrëdhëniet e tyre gjatë periudhës së rikuperimit dhe riintegrit. Për shembull, shumë viktima kanë migruar për shkak të problemeve ekonomike në familje, dhe në përgjithësi situata e tyre ekonomike është përkeqësuar më shumë për shkak të trafikimit. Për rrjedhojë, riintegrit nuk ka të bëjë vetëm me adresimin e impaktit që ka pasur trafikimi në jetën e viktimave, por edhe me adresimin e cenueshmërive (faktorëve vulnerabël) të situatës së para trafikimit, si dhe të sfidave që shfaqen në jetë pas përfundimit të periudhës së trafikimit dhe shfrytëzimit.

Cënueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse përpara trafikimit, për shkak të trafikimit dhe pas trafikimit



Riintegrit është proces i rikuperimit dhe përfshirjes ekonomike dhe sociale pas një përvoje trafikimi. Ai mund të kuptohet më mirë si një proces që personat e trafikuar e përshkojnë teksa rikuperohen dhe lënë pas shfrytëzimin, trafikim. Riintegrit i suksesshëm përfshin:



Sistemimin në një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt,



Aksesin në një standard të arsyeshëm jetese,

¹ Kjo pjesë bazohet në punën e kryer nga Instituti NEXUS dhe 15 OJF në Ballkan, duke përfshirë D&E, në kuadër të Programit të Riintegrit të Viktimave të Trafikimit (PRVT), të zbatuar gjatë viteve 2006-2015 dhe të financuar nga Fondacioni King Baudouin (KBF). Për më shumë informacion rreth PRVT-së, ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/past-projects/trafficking-victims-reintegration-programme-tvrrp/>

Kjo pjesë bazohet edhe te puna e Institutit NEXUS në projekte të tjera, duke përfshirë: Nismën Rajonale për Riintegrit: Sfidat për Riintegritin në Nënrajonin e Mekongut të Madh, në bashkëpunim me UNIAP dhe qeveritë COMMIT në Nënrajonin e Mekongut të Madh për periudhën 2010-2017 (ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/past-projects/commit-ppc5-regional-reintegration-initiative/>) dhe Mbrojtjen e Paasistuarve dhe të Nënshërbyerve: Studim afatgjatë i bazuar në evidenca mbi asistencën dhe riintegritin, i zhvilluar në partneritet me Qeverinë e Indonezisë dhe partnerë të shoqërisë civile në Indonezi, për periudhën 2013-2019 (ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/past-projects/reintegration-in-indonesia/>). Për burime dhe kërkime kyç, ju lutemi shihni: <https://nexusinstitute.net/publications/assistance-and-reintegration-of-trafficking-victims/>



Mirëqenien mendore dhe fizike,



Mundësitë për zhvillim personal, social dhe ekonomik, dhe



Aksesin në mbështetje sociale dhe emocionale²

Riintegrimi mund të përfshijë kthimin në familjen dhe/ose komunitetin e vet të origjinës. Ai mund të përfshijë edhe integrimin në një komunitet të ri, ose madje në një shtet të ri.

Një aspekt kryesor i riintegrimit të suksesshëm është ai i fuqizimit, mbështetjes së viktimave për të zhvilluar aftësi për të qenë të pavarur dhe të vetëmjaftueshëm, dhe për t'u përfshirë në mënyrë aktive në rikuperimin dhe riintegrimin e tyre.


Komponentët e ndryshëm të riintegrimit të suksesshëm



Trafikimi ndikon edhe në marrëdhëniet familjare të viktimës dhe shumë viktimë përballen me tensione dhe probleme në mjediset e tyre familjare, si dhe në mjedise më të gjera shoqërore. Për rrjedhojë, ka nivele të ndryshme ku mund të ndodhë riintegrimi, dhe se çfarë duhet marrë në konsideratë lidhur me mënyrën se si profesionistët punojnë dhe i mbështetin viktimat gjatë gjithë procesit të rikuperimit dhe riintegrimit. Riintegrimi nënkupton kapërcimin e këtyre problemeve dhe ndjeshmërive nëpërmjet këtyre niveleve - individual, familjar, komunitar dhe strukturor – dhe maksimizimin e burimeve të ripërteritjes dhe mbështetjen në jetën e viktimave dhe në mjedisin e gjerë.

² Ky përkufizim u zhvillua në bashkëpunim me Institutin NEXUS dhe 15 OJF partnere në kuadër të programit PRVT të KBF-së. Ju lutemi shihni: Surtees, R. (2008) *Ri/integrimi i personave të trafikuar: si mund të jetë puna jonë më efektive?* Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni King Baudouin, f. 11.

Nivelet e riintegrit: individual, familjar, komunitar dhe strukturor³



Niveli individual. Riintegrimi duhet të adresojë ndikimin e trafikimit (fizik, psikologjik, social dhe ekonomik) te vetë viktimat. Disa viktimat përballen edhe me probleme të ndërlikuara dhe të pazgjidhura, madje edhe me traumën përpara trafikimit. Është e nevojshme që të identifikohen nevojat e çdo viktime, si dhe kapacitetet, aftësitë dhe burimet për të ofruar asistencë të përshtatur dhe të personalizuar, dhe për të maksimizuar burimet e tyre personale të forcës dhe aftësisë ripërtëritëse.



Niveli familjar. Riintegrimi ndodh shpesh në mjedisin familjar të viktimës. Mjedisin familjar është shpesh një terren kompleks me shtresa të ndryshme mbështetjeje dhe tensionesh. Në procesin e riintegritit mund të përfshihet një numër i madh pjesëtarësh të familjes, në shkallë dhe faza të ndryshme të jetës pas trafikimit dhe mund të shfaqin veprime dhe reagime, qëndrime dhe sjellje të ndryshme (dhe shpesh kontradiktore), sidomos me kalimin e kohës dhe si përgjigje ndaj faktorëve të jashtëm. Disa pjesëtarë të familjes janë mbështetës dhe ndihmues; të tjerët mund të jenë kritikë dhe jombështetës. Të gjithë këta faktorë dhe ndryshime ndikojnë në mënyrë të diferencuar në rezultatet e riintegritit për viktimat dhe familjet e tyre të gjera; disa herë pozitivisht, dhe herë të tjera negativisht. Puna me familjen përfshin nxitjen e një mjedisi të shëndetshëm dhe mbështetës për kthimin e viktimave, dhe për jetën e familjes në përgjithësi. Gjithashtu, ajo përfshin shpesh ofrimin e mbështetjes për pjesëtarë të ndryshëm të familjes, si për shembull mbështetje për rregjistrimin dhe ndjekjen e shkollës për fëmijët e viktimave të trafikimit ose mundësi punësimi për prindërit e viktimave të trafikimit.



Niveli komunitar. Mjedisin komunitar është një faktor i rëndësishëm në suksesin ose dështimin e riintegritit të viktimave. Komuniteti përfshin ata që janë pranë dhe që përfshihen ngushtësisht në jetën e një viktime të trafikimit, si dhe ata në sferën e gjerë (dhe më distante) shoqërore të viktimës (shokë, të afërm, fqinj, bashkëmoshatarë, kolegë pune, drejtues komuniteti). Mjedisin komunitar mund të jetë një mjedis kompleks dhe kontradiktore, i cili është mbështetës dhe jombështetës dhe përfshin reagime të ndryshme (madje kontradiktore) nga shokët, fqinjët dhe të tjerët, duke përfshirë ndryshime me kalimin e kohës. Në nivel komunitar, është e rëndësishme të vlerësohet dhe nxitet një mjedis i shëndetshëm nëpërmjet krijimit të rrjeteve shoqërore, sigurimit të disponueshmërisë dhe aksesit në

³Surtees, R. (2017) *Të ecim përpara. Riintegrimi në familje dhe komunitet i viktimave të trafikimit në Indonezi*. Uashington DC: Instituti NEXUS; Surtees, R. (2017) *Jeta jonë. Cenueshmëria dhe aftësia ripërtëritëse te viktimat e trafikimit në Indonezi*. Uashington DC: Instituti NEXUS.

shërbime dhe mundësi, dhe punës me pjesëtarët e komunitetit për të luftuar stigmën dhe diskriminimin.



Niveli strukturor. Riintegrimi në shoqërinë formale dhe institucionet e saj përfshin garantimin se viktimat e trafikimit kanë status juridik, i cili iu jep atyre të drejtën për shërbime dhe që këto shërbime të jenë të disponueshme dhe të aksesueshme, veçanërisht në nivel vendor ku këto viktima të trafikimit riintegrohen.

Rezultatet e riintegrit të suksesshëm⁴

Riintegrimi i suksesshëm në përgjithësi do të thotë se viktimat e trafikimit kanë arritur rezultatet të paraqitura si më poshtë.



⁴ Surtees, R. (2010) *Monitorimi i programeve të ri/integrimit kundër trafikimit. Manual*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni King Baudouin.

Për të arritur këto rezultate, viktimat e trafikimit kërkojnë mbështetje dhe shërbime të ndryshme për t'u rikuperuar dhe riintegruar pas trafikimit. Ata mund të kërkojnë një shërbim të vetëm (për shembull, transport, kujdes mjekësor për urgjenca, sistemim në punë) ose shërbime të shumëfishta (për shembull, një ndërthurje e strehimit, asistencës mjekësore, kujdesit psikologjik, mbështetjes ligjore, arsimit dhe formimit profesional). Shërbimet mund të jenë specifike për trafikimin (të ofruara nga organizata dhe institucione kundër trafikimit) ose mund të jenë më të përgjithshme (për shembull, të ofruara nga agjenci/institucione që punojnë me personat e cenueshëm, migrantët e kthyer, zhvillimin komunitar, mbrojtjen e fëmijëve). Një paketë gjithëpërfshirëse e asistencës për riintegrim përfshin format e mbështetjes, shërbimet të paraqitura më poshtë.

Asistenca dhe shërbimet për rikuperimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit⁵



Strehim, akomodim dhe alternativa të kujdesit. Ofrimi i akomodimit të sigurt, të kënaqshëm dhe të përballueshëm dhe i alternativave të kujdesit (për shembull, në një strehëz, duke jetuar me familjen, në apartament me qira, familje kujdestare, sistemim alternativ).



Asistencë mjekësore. Asistencë dhe kujdes mjekësor i përshtatshëm, i mjaftueshëm dhe i ndjeshëm në planin afatshkurtër dhe afatgjatë, duke përfshirë kujdesin dentar, trajtimin mjekësor të specializuar kur nevojitet, dhe trajtimin për probleme shëndetësore kronike dhe të vazhdueshme.



Mbështetje dhe këshillim psikologjik. Mbështetje dhe këshillim psikologjik i përshtatshëm, i mjaftueshëm dhe i ndjeshëm në planin afatshkurtër dhe afatgjatë (për shembull, këshillim individual dhe në grup, terapi përmes artit, muzikës dhe kërcimit, këshillim familjar).



Arsim, formim dhe aftësi për jetën. Mundësi për arsim formal dhe joformal, duke përfshirë shkollim, mbështetje për rifutjen në shkollë, formim profesional, trajnim profesional, trajnim për aftësi jetësore, dhe tutorim, këshillim dhe orientim mbi trajnime profesionale.



Mundësi për fuqizim ekonomik. Mundësi për fuqizim ekonomik, duke përfshirë sistemimin në punë, stazhin, aktivitete për gjenerimin e të ardhurave, zhvillim biznesi, këshillim dhe mentorim mbi mundësi punësimit dhe biznesi.



Asistencë dhe mbështetje administrative. Asistencë dhe mbështetje administrative e nevojshme për të adresuar ndikimin e trafikimit ose për të mbështetur riintegrimin (për shembull, marrja e dokumenteve të identifikimit ose dokumenteve të tjera zyrtare, certifikatës së lindjes, lejeve të banimit dhe punës si viktimat e trafikimit, dhe caktimi i një kujdestari ligjor në rastin e fëmijëve, marrja e dokumenteve për akses në shërbime, si strehim me qira ose i subvencionuar, ndihmë ekonomike, shërbime sociale, sigurime shëndetësore).

⁵Surtees, R. (2010) *Monitorimi i programeve të ri/integrimit kundër trafikimit. Manual*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni King Baudouin. Shihni edhe: Surtees, R. (2017) *Mbështetja e riintegrimin të personave të trafikuar. Udhëzues për Nënrajonin e Mekongut të Madh*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bangkok: UN-ACT dhe World Vision; dhe Surtees, R. et al. (2016) *Të shkojmë në shtëpi: Riintegrimi i viktimave të trafikimit në Indonezi*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS.



Asistencë dhe mbështetje ligjore. Asistencë dhe mbështetje për viktimat e trafikimit në procese ligjore, duke përfshirë procese gjyqësore penale, civile dhe lidhur me marrëdhëniet e punës. Asistenca dhe mbështetja juridike mund të jetë e lidhur me përvojën e tyre të trafikimit (për shembull, si viktimë-dëshmitar në procese gjyqësore penale, kërkesa për kompensim) ose me çështje të tjera ligjore të hasura gjatë riintegrit (për shembull, divorci, aksesit ose kujdestaria e fëmijës, pronësia e pasurisë, pagesat e mbështetjes së fëmijës).



Masa të sigurisë dhe sigurimit. Masat për të garantuar sigurinë dhe sigurimin e viktimave të trafikimit në faza të ndryshme pas trafikimit, duke përfshirë vlerësime të familjes dhe rrezikut, mbrojtja e viktimës-dëshmitarit.



Asistencë për pjesëtarët e familjes së viktimës. Nxitje dhe mbështetje e një mjedisi të shëndetshëm familjar nëpërmjet formave të ndryshme të asistencës për pjesëtarët e familjes së viktimës (për shembull, fëmija, bashkëshorti/bashkëshortja, motra/vëllai, prindi).



Menaxhimi i rastit. Hartimi dhe zbatimi i një plani individual të asistencës dhe riintegrit, në bashkëpunim me viktimën e trafikimit, duke përfshirë ofrimin e shërbimeve ose koordinimin e referimit të viktimës në organizata/institucione të tjera për shërbime.



Asistencë për kthimin. Mbështetje për kthimin vullnetar të viktimave të trafikimit në shtetin e tyre dhe në vendin e origjinës ose banimit, duke përfshirë ofrimin e transportit dhe përgatitjen e dokumentacionit. Në disa raste, nevojat për asistencë janë rrjedhojë direkte e trafikimit.

Tre fazat e rikuperimit dhe riintegritimit⁶

Riintegrimi pas përvojës së trafikimit është një proces afatgjatë që zgjat për shumë muaj dhe vite. Riintegrimi mund të zbërthehet në tre faza të veçanta gjatë një periudhe rreth tre vjet.

Tre fazat e riintegritimit



Faza 1. Ndërhyrja gjatë krizës (nga 0 në 6 muaj). Faza e krizës mund të zgjasë deri në gjashtë muaj, ndoshta edhe më shumë, në varësi të natyrës dhe shkallës së shfrytëzimit të individit, si dhe të sfidave dhe cenueshmërive para dhe pas trafikimit. Për shembull, zakonisht fëmijët kërkojnë më shumë kohë në fazën e krizës pasi kanë aftësi përballimi më pak të zhvilluara. Viktimat në rrezik për sigurinë (për shembull, për shkak se kanë denoncuar trafikantin e tyre) kërkojnë shpesh më shumë kohë në këtë fazë. Viktimat që janë gra shtatzëna ose të shoqëruara me fëmijët e tyre qëndrojnë zakonisht për periudha më të gjata kohore në këtë fazë krize, pasi kanë nevojë për mbështetje dhe shërbime gjatë periudhës para dhe pas lindjes, duke përfshirë aftësitë e prindërimit. Gjithashtu, ato kanë nevojë për mbështetje në trajtimin e traumës dhe qëndrueshmërinë e tyre emocionale, sidomos për të qenë në gjendje që të kujdesen për fëmijët e tyre. Shumë viktimat me probleme të shëndetit mendor kanë nevojë për mbështetje më afatgjatë dhe më intensive në fazën e krizës, dhe shpesh edhe pas kësaj faze.



Faza 2. Tranzicioni (nga 7 në 12 muaj). Faza e tranzicionit zgjat zakonisht rreth gjashtë muaj (nga muaji i 7-të tek i 12-ti i procesit të riintegritimit). Megjithatë, kjo periudhë mund të jetë më e shkurtër në situatat kur viktimat kanë një profesion ose kanë përvojë të mëparshme pune, ose nëse kanë një mjedis të shëndetshëm familjar ku mund të kthehen. Por, mund të jetë edhe më e gjatë në rast se viktimat kanë nivel të ulët arsimor ose nuk kanë përvojë formimi profesional apo pune. Në përgjithësi, edhe fëmijët kanë nevojë për më shumë kohë në këtë fazë, kryesisht ata me marrëdhënie jo të mira me prindërit, ose ata që kanë marrëdhënie familjare të vështira ose të pashëndetshme.



Faza 3. Riintegrimi dhe përfshirja (nga 13 në 36 muaj). Faza e riintegritimit dhe përfshirjes zgjat zakonisht dy vjet, gjatë muajve 13-36, por varion nga njëra viktimë te tjetra, dhe në varësi të përvojave të tyre jetësore specifike dhe të kushteve të riintegritimit. Disa viktimat mund të lëvizin më shpejt gjatë fazës së riintegritimit dhe përfshirjes (për shembull, kur kanë një punë të qëndrueshme,

⁶ Surtees, R. (2010) *Monitorimi i programeve të ri/integrimit kundër trafikimit. Manual*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni King Baudouin.

mbështetje nga familja e tyre, një vend për të jetuar, një mjedis shoqëror të shëndetshëm dhe akses në shërbime komunitare).

Procesi i plotë i rikuperimit dhe riintegrit (kriza, tranzicioni, dhe riintegrimi e përfshirja) zgjat zakonisht rreth tre vjet. Megjithëse kjo ndarje dhe afat kohor ofron një orientim të dobishëm, secila viktimë ka nevojë për periudha të ndryshme kohore për t'u rikuperuar dhe riintegruar pas një përvoje trafikimi. Disa viktima riintegrohen me sukses përpara përfundimit të kësaj periudhe trevjeçare. Viktima të tjera të trafikimit mund të kenë nevojë për pesë vjet që të rikuperohen nga shfrytëzimi i tyre, në mënyrë që të riintegrohen me sukses. Profesionistët e riintegrit duhet të jenë fleksibël në hartimin dhe zbatimin e çdo plani riintegrit, duke përfshirë afatet e nevojshme kohore. Nevoja për një afat kohor më të gjatë për riintegrit është e zakonshme te viktimat “problematike” ose “komplekse”, pra te viktimat me vështirësi akute ose nevojave komplekse, ose që janë marrë më pak në konsideratë në kuadrin kundër trafikimit.⁷ Këto mund të përfshijnë, por nuk kufizohen, viktima të trafikimit:

- ☼ Me aftësi të kufizuara fizike dhe/ose mendore
- ☼ Me probleme me abuzimin me substanca
- ☼ Me probleme të shëndetit mendor
- ☼ Me gjendje mjekësore të rëndë ose kronike
- ☼ Me probleme të sigurisë
- ☼ Pa dokumente ose status juridik
- ☼ Pa mbështetje familjare
- ☼ Që kanë pasur përvoja me të qenit të marginalizuar ose diskriminuar në aspektin social (duke përfshirë minoritete etnike, kombësi të ndryshme, dhe individë që identifikohen si (LGBTQ+)
- ☼ Me përvoja të shkuara të abuzimit, dhunës ose neglizhencës (veçanërisht në mjedis familjar)
- ☼ Që janë të shtatzëna ose që kanë fëmijë në varësi (veçanërisht prindërit e vetëm)
- ☼ Që nuk janë marrë mjaftueshëm në konsideratë në kuadrin kundër trafikimit (burra dhe djem të trafikuar)

Rastet “e vështira” ose “komplekse” kërkojnë shpesh akses në shërbime të shumëfishta dhe të vazhdueshme, kujdes të specializuar ose mbështetje intensive gjatë një periudhe më të gjatë se ajo e zakonshme, si dhe menaxhim më intensiv të rastit dhe/ose mbështetje afatgjatë për riintegritin.

Pengesat dhe sfidat e riintegrit


Riintegriti kuptohet shpesh si proces linear, në të cilin viktimat bëjnë gradualisht hapa përpara drejt rikuperimit dhe riintegrit. Megjithatë, realiteti është shumë më kompleks. Shumë viktima trafikimi përballen me kriza dhe pengesa në faza të ndryshme gjatë riintegrit të tyre, të cilat mund të frenojnë progresin e tyre ose madje edhe të sjellin regres në hapat e mëparshëm të riintegrit. Krizat dhe vështirësitë e zakonshme në procesin e riintegrit përfshijnë, por nuk kufizohen në:

- ☼ Vështirësitë ekonomike dhe krizën financiare, duke përfshirë mungesën e mundësive të punësimit ose humbjen e vendit të punës
- ☼ Problemet e shëndetit mendor që mund të shfaqen në faza të ndryshme
- ☼ Sëmundjet ose lëndimet që ndikojnë në mirëqenien ose aftësinë për punë
- ☼ Konfliktet, tensionet dhe mosmarrëveshjet në familje
- ☼ Dhunën dhe abuzimin në familje (dhuna në familje, abuzimi i fëmijëve, incesti)
- ☼ Tensionet dhe konfliktet me pjesëtarët e komunitetit
- ☼ Çështjet e sigurisë si viktimë-dëshmitar (kërcënime dhe kanosje, kur trafikanti shpallet i pafajshëm ose del nga burgu)
- ☼ Procesin e gjatë gjyqësor dhe mungesën e aksesit efikas në drejtësi
- ☼ Problemet shëndetësore që prekin viktimat ose familjet e tyre (duke përfshirë ndikimin në kostot për kujdes shëndetësor)

⁷ Për trajtimin e riintegrit të viktimave në situata të vështira, ju lutemi shihni: Surtees, R. (2008) *Riintegriti i personave të trafikuar. Trajtimi i rasteve “problematike”*. Uashington, D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni King Baudouin.

- ☘ Përfundimin e asistencës së rregullt dhe mbështetjes e ndjekjes së riintegrit
- ☘ Vështirësitë e hasura nga disa përfitues për të qenë të pavarur dhe autonomë
- ☘ Ngjarjet e jashtme dhe krizat, duke përfshirë fatkeqësitë natyrore, si tërmetet dhe pandemitë botërore

Pengesat dhe sfidat gjatë procesit të riintegrit



Në rastin e fëmijëve, pengesat mund të lindin nga vështirësitë në regjistrimin ose vazhdimin e arsimit, dhe nga mungesa e shërbimeve dhe procedurave specifike për fëmijën ose të ndjeshme ndaj fëmijës në nivel vendor. Në përgjithësi, fëmijët, adoleshentët dhe të rinjtë mund të jenë më të ekspozuar ndaj pengesave dhe krizave, për sa u përket kapaciteteve të tyre zhvilluese, identiteteve të tyre ende në zhvillim dhe varësisë së tyre të madhe nga familja dhe të rriturit e tjerë që kujdesen për ta. Po ashtu, fëmijët janë mjaft të cenueshëm ndaj hakmarrjes së trafikantëve dhe dhunës fizike dhe emocionale në përgjithësi, në mjedise të ndryshme (shtëpi, shkollë, komunitet).

Fakti nëse këto pengesa e devijojnë në mënyrë të përkohshme apo të përhershme procesin e riintegrit të përfituesit është një funksion i rrethanave të tyre individuale (mekanizmat e tyre individuale ose sociale të përballimit) dhe i mbështetjes së disponueshme nëpërmjet programeve të riintegrit. Të qenit në gjendje për t'u mbështetur te dikush në familjen ose rrjetin e vet shoqëror është pjesë përbërëse e të qenit në gjendje për të përballuar dhe kapërcyer problemet dhe pengesat që mund të lindin. Alternativa e kthimit për mbështetje dhe shërbime riintegritimi në çdo fazë të jetës pas trafikimit të dikujt është e rëndësishme për të zbutur pengesat. Megjithatë mbështetja mund të jetë specifike për trafikimin, është e rëndësishme që të merren në konsideratë dhe të maksimizohen forma të tjera në nivel komunitar, si shërbime sociale të qeverisë qendrore, OJF vendore, organizata fetare dhe grupe komunitare.⁸

⁸ Surtees, R. (2008) *Riintegritimi i personave të trafikuar. Si mund të jetë më efektive puna jonë*. Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni King Baudouin. Shihni edhe: Surtees, R. (2007) *Duke dëgjuar viktimat: Përvojat e identifikimit, të kthimit dhe të ndihmës në Evropën Juglindore*. Vjenë: ICMPD, Instituti NEXUS & USAID, f. 188-89.






Mentorimi i viktimave të trafikimit. Një model për riintegrim.

Çfarë është mentorimi?

Mentorimi është një proces në të cilin një individ me përvojë ndihmon një person tjetër të zhvillojë qëllimet dhe aftësitë e tij nëpërmjet një sërë bisedash të kufizuara në kohë, konfidenciale dhe aktivitete të tjera⁹. Një mentor është përgjithësisht një individ më me përvojë që krijon një marrëdhënie me një person që nuk ka patur lidhje më parë për të ofruar mbështetje, udhëzime dhe inkurajim të vazhdueshëm, për të ndihmuar personin të zhvillojë aftësitë dhe karakterin e tij, të rifitojë kontrollin mbi jetën e tij dhe të realizojë potencialin e tij¹⁰.

Marrëdhënia mentoruese gjithashtu u siguron viktimave - të mentoruarve një marrëdhënie ku ata marrin vëmendje, e cila mund t'u ketë munguar në mjedisin e tyre personal dhe familjar. Mentorimi i suksesshëm do të krijojë rezultate në ndryshim, rritje ose zhvillim për mirë.

Përfitimet e mentorimit përfshijnë:

-  Inkurajon rritjen emocionale dhe sociale
-  Prezanton përfituesin me një model pozitiv dhe një marrëdhënie të shëndetshme personale
-  Ndihmon viktimën-përfituesin e programit të fokusohet në rimëkëmbjen dhe riintegrimin
-  Ndërton dhe përmirëson vetëbesimin dhe vetëvlerësimin
-  I siguron viktimës-te mentoruarit një marrëdhënie ku ata marrin vëmendje dhe inkurajim

Aspektet e zakonshme të marrëdhënies mentoruese janë:

- Mentori është dikush me më shumë përvojë ose mençuri sesa i mentoruari
- Mentori jep udhëzime ose orientime që kanë për qëllim të lehtësojnë rritjen dhe zhvillimin e të mentoruarit
- Ka një marrëdhënie besueshmërie dhe besimi ndërmjet mentorit dhe të mentoruarit¹¹

⁹ D&E dhe KMOP (2019) *Trajnim mbi mentorimin – mbështetje nga ish-viktimat*. Tiranë: Të Ndryshëm dhe Të Barabartë, Athinë: Qendra për Veprim Social dhe Inovacion (KMOP).

¹⁰ Përshtatur nga DuBois, D.L. dhe M.J.Karcher(2005) *Udhëzuesi i mentorimit të të rinjve*. Londër: Botimet SAGE; dhe Ministria e Shëndetësisë (2013) *Udhëzimet e praktikës së sigurt për programet e mentorimit të të rinjve*. Uellington, Zelandë e Re: Ministria e Shëndetësisë

¹¹DuBois, D.L. dhe M.J.Karcher(2005) *Udhëzuesi i mentorimit të të rinjve*. Londër: Botimet SAGE, f. 3.

Marrëdhëniet mentoruese mbështeten te reciprociteti, besimi dhe empatia, dhe synojnë të mbështetin zhvillimin e të mentoruarit, duke përfshirë vetëbesimin. Kjo përfshin mbështetjen e të mentoruarit lidhur me:

“ Doja të ndihmoja vajzat që kishin nevojë të flisnin dhe të ndiheshin të sigurt. Më mungonte kjo, dhe pasja e një mentori është ndihmë e madhe. (Mentor, ish-viktimë e trafikimit)

”

- ✓ Zhvillimin social dhe emocional (duke sfiduar perceptimin negativ të të mentoruarit mbi veten dhe duke korigjuar marrëdhëniet negative të shkuara)
- ✓ Zhvillimin konjitiv (duke ndërtuar procese të të menduarit, përfshi të kujtuarit, zgjidhjen e problemeve dhe vendimmarrjen nëpërmjet ndërveprimeve sociale)
- ✓ Zhvillimin e identitetit (nëpërmjet të cilit të rinjtë brendësojnë qëndrimet, sjelljet, tiparet e atyre që dëshirojnë të imitojnë)¹²

Mentorimi është zbatuar për të punuar me fëmijët dhe të rinjtë vulnerabël, duke përfshirë ata që kanë qenë të ekspozuar ndaj traumave psikologjike, ata me sëmundje mendore ose probleme të abuzimit me substancat, emigrantët dhe refugjatët, grupet minoritare, ata që dalin nga institucionet e kujdesit rezidencial, e tëtjera.

Nëse kjo qasje është e përshtatshme për viktimat e trafikimit, varet nga një sërë faktorësh individualë, familjarë dhe socialë. Mentorimi mund të jetë gjithashtu më i përshtatshëm për disa viktimat të trafikimit se të tjerët, dhe më i zbatueshëm në kontekste të caktuara dhe në kuadrin e disa programevetë riintegrit.

Karakteristikat e mentorëve

Ka një sërë karakteristikash që janë të rëndësishme për mentorin/mentoren. Këtu përfshijmë:

“ Disa këshilla, fjalë të mira.... mjaftojnë për të qenë mentor ... të jesh i pjekur, të japësh këshilla, si dhe të kesh një karakter të mirë. (Viktimë - i/e mentoruar)

”

- **Dëgjues të mirë dhe aktivë.** Të dëgjuarit aktiv është aftësia më e rëndësishme që një mentor përdor gjatë gjithë marrëdhënies së tij mentoruese. Ai është i rëndësishëm për krijimin e raportit me të mentoruarin, dhe kontribuon për një mjedis pozitiv dhe pranues që lejon komunikimin e hapur. Dëgjuesit aktivë tregojnë interes për të mentoruarin dhe janë në gjendje të rikujtojnë dhe reflektojnë edhe mbi gjërat që janë ndarë në bisedat e mëparshme. Ata përqendrohen plotësisht, duke pakësuar ndërprerjet dhe shpërqendrimet teksa komunikojnë me të mentoruarin. Dëgjuesit aktivë janë të vëmendshëm për të dëgjuar gjithçka që i mentoruari dëshiron të ndajë përpara se të japin ndonjë mendim apo këshillë.
- **Të qëndrueshëm, të besueshëm dhe të angazhuar.** Të mentoruarit duhet të jenë në gjendje të mbështeten te mentori i tyre. Qëndrueshmëria është tipari dallues i marrëdhënies mentoruese. Kjo do të thotë të jesh seriozisht në dispozicion të të mentoruarit siç është rënë dakord nga fillimi, duke respektuar takimet dhe thirrjet e planifikuara, dhe duke treguar vazhdimisht interes dhe mbështetje. Mentori duhet të vazhdojë t'i përkushtohet të mentoruarit të tij, madje edhe kur gjërat nuk shkojnë mirë, pasi të mentoruarit mund ta largojnë mentorin si formë vetëmbrojtjeje derisa të besojnë se mentori nuk do t'i zhgënjejë.

¹²DuBois, D.L. dhe M.J.Karcher(2005) *Udhëzuesi i mentorimit të të rinjve*. Londër: Botimet SAGE, f. 31-35.

- **Të besuar.** Të mentoruarit duhet të jenë në gjendje t'iu besojnë mentorëve të tyre, pasi ata do të ndajnë me këta të fundit tema shumë personale dhe të ndjeshme. Kjo kërkon edhe të qenit të sigurt se mentorët do t'i mbajnë të gjitha bisedat dhe komunikimet e tjera me të mentoruarin konfidenciale dhe private.
- **Inkurajues dhe mbështetës.** Mentorët duhet të jenë pozitivë dhe inkurajues, dhe të vlerësojnë kapacitetin dhe arritjet e të mentoruarve të tyre. Ata duhet të jenë mbështetës kur të mentoruarit shprehin frustrimin dhe zhgënjimin e tyre. Të mentoruarit duhet ta dinë dhe ta ndiejnë se nuk janë të vetëm dhe se edhe mentorët kanë bërë gabime dhe janë përballur me sfida.
- **Mirëkuptues dhe empatikë.** Mentorët e zotë janë vërtet të interesuar që t'i mirëkuptojnë personat që po mentorojnë dhe të shfaqin empati ndaj tyre. Ata vlerësojnë mendimet e të tjerëve dhe punojnë për t'i parë gjërat nga pikëpamja e të mentoruarit. Mirëkuptimi dhe kujdesi i vërtetë për të mentoruarin është çelësi i zhvillimit të një marrëdhënieje besimi.
- **Të ndershëm dhe të drejtë.** Mentorët e suksesshëm janë të ndershëm dhe të drejtë kur japin komentet dhe udhëzimet e tyre. Ata e ndërtojnë marrëdhënien duke qenë të hapur dhe të ndershëm gjatë gjithë marrëdhënies mentoruese, dhe kanë vullnet që të shqyrtojnë dhe diskutojnë çdo çështje.
- **Të respektuar.** Mentorët respektohen nga kolegët e tyre dhe nga profesionistët e tjerë pranë tyre. Në përgjithësi, mentorët kanë një formim në çështjet sociale dhe janë të interesuar për të ndihmuar personat në nevojë. Ata vlerësojnë vullnetarizmin.
- **Me vullnet për të ndarë informacion.** Mentorët dëshirojnë vërtet që të ndajnë ato që dinë me të tjerët, të cilët mund të përfitojnë nga njohuritë dhe përvoja e tyre.
- **Motivues.** Mentorët i motivojnë të mentoruarit e tyre dhe i inkurajojnë të kapërcejnë sfidat. Për shembull, ata motivojnë nëpërmjet qëndrimit, sjelljeve dhe sukseseve të tyre.
- **Shembull modeli pozitiv.** Mentorët iu ofrojnë të mentoruarve një shembull modeli pozitiv për të orientuar sjelljen dhe marrëdhëniet e tyre. Ata janë shembuj model për të mentoruarit, si dhe model nëpërmjet marrëdhënies mentor-i mentoruar, marrëdhënieve ndërpersonale pozitive dhe të shëndetshme.

Ndërkohë që mentorimi ka si qëllim të tij kryesor të ofrojë mbështetje për të mentoruarin, marrëdhënia sjell edhe përfitime për mentorët, duke përfshirë:



Një marrëdhënie të re



Një shans për të ndihmuar dikë në nevojë



Mundësinë për të kontribuar për shoqërinë



Mundësinë për zhvillim dhe rritje profesionale



Motivimi im për t'u bërë një mentor vjen nga fakti se kisha mundësinë të kisha një mentor të zotë dhe një menaxher rasti që më ndihmoi dhe më ndryshoi jetën. Ja përse doja të bëja të njëjtën gjë... çdo të mirë që kam marrë, të jem në gjendje t'ia kthej dikujt tjetër. (Mentore, ish-viktimë e trafikimit)





Kënaqësi personale kur ndihmon një person që ka përjetuar përvoja trafikimi.



Përmirësim të aftësive ndërpersonale



Fokusin jashtë vetes



Njohje më të thellë të çështjeve dhe problemeve sociale të të rinjve



Të ndjerit i dobishëm, si profesionalisht ashtu edhe personalisht



Një ndjenjë plotësimi (personal dhe profesional) nga ndarja e njohurive në shërbim të kauzës



Motivimi im për t'u bërë mentore ishte të ndihmoja vajzat. Për t'iu dhënë kurajë për të ecur përpara dhe për t'u pjekur, dhe për të përmirësuar cilësinë e jetës së tyre. (Mentore, ish-viktimë e trafikimit)



Roli i mentorëve në rikuperimin dhe riintegrimin e viktimave të trafikimit

Mentorimi gjatë riintegrimin të viktimave të trafikimit

Mentorimi në kontekstin e riintegrimin të pas-trafikimit duhet të projektohet për të njohur dhe përshtatur situatën unike dhe dobësitë/vulnerabilitetin e viktimave të trafikimit. Ai gjithashtu kërkon shqyrtimin e variacionit të gjerë në përvojat midis viktimave të trafikimit dhe se si kjo ndikon se kush mund ose nuk mund të jetë i përshtatshëm për t'u përfshirë në një program mentorimi.



Mentorimi është një pjesë shumë e rëndësishme e procesit të riintegrimin. Kjo ndodhndërmjet mentorit dhe të mentoruarit, i cili ndërvepron në një fushë të caktuar në interes të zhvillimit, fuqizimit, vetëbesimit, socializimit etj, të përfituesit. (Menaxher rasti)



Viktimat e trafikimit, gjatë shfrytëzimit të tyre, kanë përjetuar trauma të përsëritura dhe këto përvoja traumatike ndikojnë në mirëqenien e tyre fizike, psikologjike, sociale dhe shpirtërore. Për të nxitur rezultate pozitive, mentorët duhet të marrin parasysh se si trauma ndikon negativisht në reagimin e një të mbijetuarit ndaj mjedisit, stresit dhe aktiviteteve të përditshme.

Përvoja e trafikimit shpesh shkakton shtresa komplekse traume mbi të mbijetuarit. Abuzimi që viktimat kanë duruar mund të ketë ndikuar në ndjenjën e tyre për veten dhe ata që i rrethojnë, duke rezultuar shpesh në mosbesim ndaj të tjerëve dhe duke ndërprerë aftësinë e tyre për të pasur marrëdhënie të shëndetshme ndërpersonale. Në mënyrë paradoksale, shumë nga sjelljet e shfaqura nga individët që kanë përjetuar trafikim janë në fakt aftësi që i ndihmuan ata t'i mbijetonin shfrytëzimit. Dhe duhet kohë që një viktimë trafikimi të mësojë se si të përballet dhe të përgjigjet kur nuk është më në modalitetin e mbijetesës.

Procesi i mentorimit të viktimave të trafikimit gjatë rikuperimit dhe riintegrimin të tyre fokusohet kryesisht në ofrimin e mbështetjes dhe motivimit ndërsa ndërtojnë një jetë të re dhe në minimizimin e izolimit të tyre duke ofruar një marrëdhënie të sigurt në të cilën ata mund të përballojnë dhe procesojnë ngjarjet e tyre traumatike. Roli i mentorit është të respektojë dhe pohojnë përvojat e të mentoruarit dhe të ndihmojë ata të përpunojnë ndjenjat e tyre.

Mentorimi i viktimave të trafikimit mund të jetë sfidues duke pasur parasysh traumën dhe shfrytëzimin që kanë pësuar. Mentorët duhet të jenë të përkushtuar ndaj marrëdhënies edhe nëse i mentoruari i tyre ngre mure, bën një gabim ose mbyllet në vetevetë, pasi këto janë shpesh përgjigje ndaj traumës që kanë përjetuar. Trajnimi duhet të përgatisë mentorët për ta kuptuar këtë dhe të ofrojë mbështetje programore për mentorët që të diskutojnë me lehtësi këto përvoja.



Mentorimi është një përvojë jetësore, që do të thotë se ju mund të praktikoni njohuritë, të mësoni gjëra të reja dhe ta bëni këtë në një mënyrë shumë të bukur, duke u socializuar dhe argëtuar. (Menaxheri rasti)



Marrëdhënia mentor-përfitues (i mentoruar) është një marrëdhënie sfiduese përt'u krijuar, e vështirë për t'u përfunduar, por e pamundur për të harruar rëndësinë dhe përfitimet që sjell në jetën e rastit. (Mentor)



Shumë viktimat e trafikimit nuk janë përfshirë kurrë në marrëdhënie pozitive dhe të shëndetshme me të rriturit mbështetës. Ata mund të kenë pak përvojë në rrugëtimin e një marrëdhënieje ku ka interes të vërtetë dhe shqetësim për mirëqenien e tyre.

Një mentor që shfaqet, pavarësisht nga rrethanat, dërgon një mesazh pozitiv për të rinjtë dhe ofron një model se si duket një marrëdhënie e shëndetshme¹³. Në të njëjtën kohë, mentorët duhet të jenë të durueshëm pasi zhvillimi i një marrëdhënieje besimi kërkon kohë. Kjo mund të bëhet duke mbajtur kontakte të qëndrueshme me kalimin e kohës, gjë që tregon përkushtim, interes dhe kujdes për të mentoruarin dhe modelon një marrëdhënie të shëndetshme dhe të qëndrueshme.

“ Do të doja të kisha një mik si mentori im në kohët e mia të vështira. (E mentoruar, ish viktimë e trafikimit)

”

Mentorimi nuk është domosdoshmërisht i përshtatshëm për të gjitha viktimat e trafikimit gjatë riintegritimit të tyre. Përkundrazi, ky model është më i përshtatshmi dhe më i rëndësishëm për viktimat e trafikimit të cilët mund të përfitojnë nga:

- Mbështetje shpesh, shoqëri dhe miqësi duke përfshirë një rrjet social
- Një model, mbështetja e të cilit mund t'i ndihmojë ata të zhvillojnë një imazh pozitiv për veten, sjellje të reja dhe aftësi përballuese
- Mbështetje nga bashkëmoshatarët ose ndër breza për t'i ndihmuar ata të përballen me sfidat e identifikuar të jetës ose të përmbushin detyrat zhvillimore¹⁴

Kjo mund të përfshijë viktimat që janë të izoluara dhe nuk kanë një rrjet social ku mund të kërkojnë mbështetje dhe këshilla dhe të zhvillojnë aftësi sociale. Mund të përfshijë gjithashtu viktimat e trafikimit që janë të izoluara dhe marxhinalizuar në aspektin social (për shembull, ato që identifikohen si LGBTQ+) ose ato që janë veçanërisht të cenueshëm/vulnerabel (për shembull, personat që kanë qenë viktimat të dhunës dhe abuzimit ose vijnë nga një familje jo mbështetëse).

“

Fillimi i ndërveprimit me njerëzit dhe botën përreth mund të jetë një proces i vështirë. Dhe pastaj ka mentor që e bën më të lehtë. (Menaxheri rasti)

”

Përveç kësaj, nga mentorimi mund të përfitojnë viktimat e trafikimit që kanë vonesa në zhvillim ose vështirësi në sjellje. Në situata të tilla, objektivat e mentorimit përputhen me aftësitë e individit dhe aktivitetet përshtaten me aftësitë dhe kapacitetet e tyre. Mentorimi i kësaj kategorie viktimash mund të kërkojë më shumë kohë për shkak të çështjeve të ndryshme që mbivendosen.

Modeli i mentorimit nuk është i përshtatshëm për:

- Viktimat me probleme sigurie pasi nuk mund të lëvizin lirshëm
- Viktimat që janë ende në krizë (për shembull, ende vuajnë nga trauma ose së fundmi janë shkeputur nga shfrytëzimi)
- Viktimat që kanë një situatë të paqëndrueshme jetese dhe të cilave nuk u janë plotësuar endenevojt bazë.

¹³ DuBois, D. dhe J. Felner(2016) *Mentorimi për të rinjtë me historik të përfshirjes në aktivitete seksuale për qëllime fitimi*. Boston: Qendra Kombëtare Burimore e Mentorimit.

¹⁴ D&E dhe KMOP (2019) *Trajnim mbi mentorimin – mbështetje nga ish-viktimat*. Tiranë: Të Ndryshëm dhe Të Barabartë, Athinë: Qendra për Veprim Social dhe Inovacion (KMOP), f. 19-20.

Përshtatshmëria e modelit të mentorimit mund të rishikohet kur të trajtohen këto çështje.

Modele të ndryshme mentorimi – mentorë dhe mentorë ish viktimë

Mentor është dikush që është një burim i mirë mbështetjeje dhe modeli për të mentoruarit. Jo çdokush ka akses në marrëdhënie të shëndetshme dhe mbështetëse dhe mentorimi, në formën e tij bashkëkohore, është një ndërhyrje e planifikuar që ka për qëllim të adresojë këtë mungesë marrëdhënies¹⁵.

Mentori merr përsipër role dhe përgjegjësi të ndryshme të jetës së të mentoruarit, duke qenë shembull model, këshillues dhe shok.

- **Shembull model:** Mentori modelon sjelljen pozitive, të shëndetshme dhe konstruktive për të mentoruarin. Vetë marrëdhënia mentoruese modelon një marrëdhënie të dobishme dhe të shëndetshme.
- **Këshillues:** Mentori i këshillon të mentoruarit lidhur me sjelljet, mendimet ose reagimet që mund të kenë nevojë për ndryshim. Këshillat përcillen në mënyrë miqësore dhe konstruktive, në mënyrë që i mentoruari të mos i perceptojë si kritika të ashpra.
- **Shok:** Mentori i siguron të mentoruarit një marrëdhënie ku ata mund të ndajnë ëndrrat dhe dëshirat e tyre, dhe të marrin siguri dhe mbështetje.

“ U ndjeva shumë mirë. Duke bërë diçka ndryshe. Kalimi i kohës me mentoren time më bëri të ndihem shumë mirë. (E mentoruar, viktimë trafikimi)

“ Mentori im është shoku im, unë mund të ndaj çdo gjë me të, ne mund të diskutojmë për shumë gjëra. Mentori im nuk mërzitet me mua, nuk ndihem sikur kam bërë diçka gabim kur tregoj të gjitha gjërat e mia. (I mentoruar, ish-viktimë e trafikimit)

Mentori *nuk* është një prind, këshilltar ose punonjës social. Por, shumë nga tiparet shoqëruese të këtyre personave janë edhe tipare të një mentori të zotë, si për shembull të qenit dëgjues i mirë dhe aktiv, mbështetës dhe inkurajues, i besuar, i qëndrueshëm dhe i besueshëm, i ndershëm dhe i drejtë, mirëkuptues dhe empatik, dhe një shembull model pozitiv.

“ Çdo rast duhet të ketë një mentor. Me mbështetjen e saj, unë kapërceva çdo sfidë. (Viktimë-i mentoruar)

Ekzistojnë dy lloje mentorësh që mund të angazhohen për të mbështetur riintegrimin e viktimave të trafikimit - **mentorë** dhe **mentorë ish viktimë (peer mentor)**¹⁶.

¹⁵Bennetts, C. (2003) ‘Mentorimi i të rinjve: Tendencat dhe tradita’, *British Journal of Guidance & Counselling*, 31(1), f. 63.

¹⁶ Variacionet e tjera përfshijnë: mentorimin në grup (një i rritur me një grup prej katër ose pesë të rinjsh), mentorimin në ekip (disa të rritur punojnë me grupe të vogla të rinjsh) dhe e-mentorimin (duke përdorur teknologjinë, si email ose Skype, si metodën kryesore të komunikimit). Disa programe mund të përdorin një kombinim të llojeve të mentorimit, si për shembull seancat e mentorimit individual dhe në grup. NZYMN (2016) *Udhëzues për praktikën e efektshme dhe të sigurt në mentorimin e të rinjve*. botimi i 2-të. Zelandë e Re: Rrjeti i Mentorimit të të Rinjve i Zelandës së Re, f. 10. Shihni edhe Rennie, P. (2016) *Udhëzues për praktikën e efektshme në monitorimin e fëmijëve dhe të rinjve që përfitojnë ose kanë përfituar shërbime të mbrojtjes së fëmijëve*. Kanada: Big Brothers, Big Sisters of Canada, f. 17-18; MENTOR dhe MHA-NYC (2009) *Të mbështesim të rinjtë Përballë Dhunës dhe Traumës* Boston:MENTORI dhe Nju Jorku: Shoqata e Shëndetit Mentor, Nju JorkTë mësojmë më shumë rreth llojeve të ndryshme të mentorimit, shihni Youth Collaboratory (2021) *Dritëdhedhje mbi Shfrytëzimin Seksual të Fëmijëve për Qëllime Tregtare: Paketë Mjetesh për të Kuptuar*

Mentor është dikush që dëshiron të ndihmojë një viktimë trafikimi gjatë riintegrimin të tij/saj. Në disa raste ky është një person që është i motivuar të dalë vullnetar nga dëshira për të ndihmuar. Në raste të tjera, këta mund të jenë profesionistë të rinj që kërkojnë një shans për të mësuar dhe praktikuar aftësitë e tyre profesionale - për shembull, një i sapodiplomuar nga shkolla e punës sociale ose psikologjisë.

Një **mentor ish viktimë** (peer mentor) është dikush që ka përjetuar një përvojë specifike (në këtë rast, trafikimin e personave) dhe që punon me dikë (një i mentoruar) i cili është i/e ri/e që sapo ka dale nga kjo përvojë. Mentorët ish viktima janë viktima të trafikimit që kanë avancuar/përparuar në procesin e tyre të riintegrimin, janë të gatshëm të ndihmojnë viktimat e tjera dhe vlerësohen si të përshtatshëm për të marrë këtë rol nga organizata ndihmëse. Në raste të tilla, mentorët bëhen bashkë me një përfitues për t'i mbështetur ata në ndërtimin e një rrjeti social në nivel komuniteti, duke kryer së bashku aktivitete të ndryshme, nga sporti dhe argëtimi deri te aktivitetet e thjeshta të përditshme. Eksperienca del nga përvojat personale dhe unike të mentorit¹⁷.

Rolet dhe përgjegjësitë janë të njëjta për mentorët dhe mentorët ish viktima. Megjithatë, në rastin e fundit, ka më tepër vështirësi, duke pasur parasysh përvojat e mëparshme të trafikimit të mentorëve bashkëmoshatare dhe kompleksitetet me të cilat ata mund të përballen gjatë riintegrimin të tyre. Këto përfshijnë:

- Rikujtimi i përjetimeve të traumës gjatë dëgjimit të historive të të mentoruarit
- Përfshirja më shumë sesa duhet në marrëdhënien mentor-i mentoruar
- Duke u ndikuar emocionalisht ndërsa punon si mentor
- Të mos qenit në gjendje për të parë përvojën e të mentoruarit si unike
- Tendenca për të dhënë zgjidhje të gatshme

Nga ana tjetër dhe pavarësisht nga këto kompleksitete e vështirësi, mentorët ish viktima mund të ofrojnë gjithashtu diçka që mentorët e tjerë nuk mundin, të kuptuarit e një përvoje trafikimi, dhe të shërbejnë si një shembull shumë real i aftësisë për të kapërcyer traumën dhe përvojat e trafikimit. Kjo do të thotë se ata shpesh kanë shumë këshilla dhe strategji praktike dhe të testuara për tejkalimin e vështirësive të hasura gjatë riintegrimin. Këto praktika të suksesshme mund të ndahen dhe të funksionojnë gjatë procesit të mentorimit. Viktimat gjithashtu mund të ndihen më të kuptuara nga dikush me përvoja të ngjashme.

më Mirë. Shtetet e Bashkuara Youth Collaboratory, OJJDP dhe Qendra për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Universitetin e Whichita-s. Vizitoni: <https://bit.ly/3FyQqgs>

¹⁷ DuBois, D. and J. Felner(2016) *Mentoring for youth with backgrounds of involvement in commercial sex activity*. Boston: National Mentoring Resource Center.

Puna me viktimat e trafikimit - mentorët dhe profesionistët e riintegrit


Menaxherët e rasteve dhe profesionistët e ekipit multidisiplinar

E mira është që mbështetja e viktimave gjatë periudhës së rikuperimit dhe riintegrit të tyre të përfshijë profesionistë të ndryshëm nga fusha të ndryshme pune. Si fillim duhet caktuar menaxheri i rastit (ose punonjësi social shtetëror ose punonjësi social nga një OJF e caktuar) për të punuar me viktimën gjatë riintegrit.

Menaxheri i rastit mbështetet nga ekipi multidisiplinar (EMD), i cili përbëhet nga:

- punonjësi social (si menaxher rasti)
- psikologu
- mjeku
- avokati
- mësuesi

Ekipi multidisiplinar (EMD) për mbështetjen dhe riintegritin e viktimave të trafikimit



EMD-ja kryen një vlerësim gjithëpërfshirës të nevojave dhe më pas menaxheri i rastit punon së bashku me viktimën për të hartuar planin individual të riintegrit. Sipas këtij plani riintegrit, anëtarët e EMD-së bashkëpunojnë me institucione dhe organizata të ndryshme për të pasur akses në shërbime për mbështetjen e viktimave të trafikimit në faza të ndryshme të riintegrit.

Pas kalimit të fazës fillestare të krizës (zakonisht pas gjashtë muajsh), viktimat kalojnë në një lloj tranzicioni drejt pavarësisë që i ndihmon të marrin në kontroll jetën e tyre si dhe të marrin përsipër më shumë përgjegjësi. Asistenca që ofrohet gjatë kësaj periudhe ka të bëjë pikërisht me mbështetjen e pavarësisë dhe autonomisë. Mbështetja vijon të mbikëqyret nga menaxheri i rastit me mbështetjen e EMD-së. Menaxherët e rastit nuk ofrojnë vetëm mbështetje të vazhdueshme, por ofrojnë edhe informacionet e nevojshme rreth shërbimeve dhe mbështetjes që këtyre viktimave u vihet në dispozicion në komunitet.

Gjatë fazës së tranzicionit, ka edhe profesionistë të tjerë që i mbështesin përpjekjet riintegruese, si:



Stafi arsimor (për shembull mësuesit, psikologët, drejtorët dhe administratorët e shkollave) për të mbështetur rikthimin në shkolla, programet alternative për aksesin në arsim, ofrimin e materialeve shkollore, aksesin te mësuesit/instruktorët dhe mbështetjen pas shkolle.



Stafi mjekësor (për shembull mjeku i familjes, administratorët mjekësorë, mjekët e specializuar si pediatër dhe psikiatër) për të pasur akses në shërbime, përfshi këtu shërbime të specializuara ose qendra komunitare të shëndetit mendor në rast se viktimat kanë probleme të shëndetit mendor.



Profesionistët për punësimin dhe fuqizimin ekonomik (për shembull stafi i zyrës së punës, administratorët, stafi i qendrave të formimit profesional) që bëjnë të mundur aksesin në formim profesional, si dhe në mundësi e programe punësimi.



Administratorët publikë (për shembull në bashki, agjenci ose zyra të ndryshme shtetërore) që mundësojnë shërbime si regjistrimin e të posalindurve, aksesin në dokumente identifikuese dhe në shërbime shtetërore si programe strehimi të subvencionuara, kujdes për fëmijët dhe regjistrimin e fëmijëve në çerdhe dhe kopsht, shërbime shëndetësore dhe ndihmë ekonomike.



Profesionistët ligjorë (për shembull avokatët, asistentët ligjorë, asistentët paraligjorë) që ofrojnë mbështetje dhe përfaqësim për viktimat apo dëshmitarët në procese gjyqësore penale e civile, akses në lejet e qëndrimit për viktimat e huaja, informacione për përfitimet shoqërore dhe të drejtat dhe aksesin në mbrojtje fizike si viktimitë trafikimi.



Punonjësi social (për shembull, punonjësit socialë shtetërorë dhe asistentët socialë) që bëjnë të mundur aksesin në shërbime dhe përfitime sociale, si dhe në të drejtat si viktimitë trafikimi.



Stafi i qendrave komunitare dhe rinore (për shembull mësuesit, edukatorët, punonjësit socialë) që mbështesin aksesin në aktivitete të ndryshme sociale për ata dhe fëmijët e tyre.

Mentorët dhe marrëdhënia e tyre me profesionistët e riintegrit

“Mentori është mjaft i dobishëm për ekipin pasi ndan këndvështrimet e zbuluara në mjedis jashtë pune. (Menaxher rasti)

”

Gjatë kësaj periudhe tranzitore, disa viktimë e shikojnë shumë të dobishme punën me mentorin ose mentorin ish-viktimë. Kjo vlen sidomos atëherë kur viktimë përfituese ka nevojë për mbështetje shtesë për të përmirësuar aftësitë komunikuese dhe ndërpersonale dhe për të mësuar se si të krijojë dhe mbajë marrëdhënie sociale të qëndrueshme. Është mjaft i dobishëm edhe në përvetësimin e aftësive dhe mënyrave të reja të sjelljes dhe ndërveprimit.

Nëse duhet angazhuar mentor për viktimën e trafikimit apo jo është një vendim që merret nga menaxheri i rastit në konsultim me supervisorin dhe drejtuesin e EMD-së dhe më pas i parashtrohet si mundësi viktimës përfituese. Kjo gjë përfshin shpjegimin e rolit të mentorit, aktiviteteve që do të zhvillohen dhe çfarë mund të mësojnë ata nga kjo marrëdhënie mentoruese. Përfshin edhe të kuptuarit e të drejtave dhe përgjegjësisë që kanë gjatë procesit të mentorimit. Përfituesit/të mentoruarit i jepet kohë të vendosë nëse do të vazhdojë ose jo me programin e mentorimit. Nëse bien dakord, u caktohet një mentor i cili është përzgjedhur me kujdes nga menaxheri i rastit.

Sapo caktohet të punojë me viktimën përfituese, mentori punon me ekipin multidisiplinar dhe i raporton drejtuesit të EMD-së dhe supervisorit të stafit duke u koordinuar me menaxherin e rastit. Mentorimi është një pjesë e një game të gjerë ndihme që u ofrohet viktimave të trafikimit për të mbështetur në rikuperimin dhe riintegrimin e tyre.

Mentorët duhet të bashkëpunojnë dhe ta koordinojnë punën me menaxherin e rastit. Marrëdhënia e mentorit me menaxherin duhet të fillojë atëherë kur fillon marrëdhënia e tij me viktimën/të mentoruarin.

Mentori duhet të jetë në komunikim të vazhdueshëm me menaxherin e rastit për të raportuar mbi progresin e përfituesit, për të kuptuar nevojat e tij dhe për të ndihmuar në planin e riintegritit të përfituesit.

Menaxheri i rastit duhet të jetë i vetëdijshëm për takimet dhe aktivitetet që zhvillohen midis mentorit dhe të mentoruarit. Mentori duhet t'i diskutojë paraprakisht aktivitetet e propozuara me menaxherin e rastit, pasi disa aktivitete mund të mos jenë të mundshme ose të këshillueshme. Mentorët nuk duhet të bëjnë plane lidhur me aktivitetet pasi moszhvillimi i një aktiviteti të planifikuar mund të perceptohet nga i mentoruari si premtim i shkelur.

Çdo pyetje ose dilemë që haset në marrëdhënien mentor-i mentoruar duhet komunikuar me menaxherin e rastit. Kur ka informacion se viktimë përfituese mund të jetë në rrezik (për shembull, i/e mentoruarit ka parë persona të dyshimtë, të afërm ose miq të trafikantit gjatë ndonjë aktiviteti të zhvilluar së bashku me mentorin), mentori duhet ta njoftojë menjëherë menaxherin e rastit dhe ta ndajë me të këtë informacion. Të gjitha bisedat dhe informacionet që nuk ndikojnë te siguria e përfituesit ose plani i riintegritit duhen mbajtur konfidenciale.

Kjo mbikëqyrje dhe supervizim u ngarkohet menaxherëve të rastit. Për çdo mentor dhe të mentoruar krijohet një dosje ku përfshihen informacione të përmbledhura rreth mentorit dhe të mentoruarit gjatë vlerësimit dhe mentorimit, si dhe një procesverbal të të gjitha takimeve dhe aktiviteteve të

“

Mentori njihet me menaxherin e rastit dhe mënyrën e punës me këtë grup të synuar. Më pas, zhvillohet takimi i parë (prezantimi) me përfituesin që do të mentorohet. Gjatë mentorimit, komunikohet vazhdimisht lidhur me progresin e mentorimit dhe për të kuptuar se cilat alternativa janë më produktive që ta ndihmojnë viktimën përfituese me gjërat për të cilat ka më tepër nevojë. (Menaxher rasti)

”

“

Stafi i organizatës ka rol të rëndësishëm në motivimin e mentorit. Përfshirja e stafit në procesin e menaxhimit të rastit dhe nxitja e mentorit nga strukturat koordinuese e bëjnë mentorin të ndihet pjesë e grupit dhe se ka ndikim domethënës në menaxhimin e rastit. (Mentor)

”

përfunduara në çdo takim mentorimi.

Kontakti midis mentorëve dhe menaxherëve të rastit mund të zhvillohet çdo javë ose çdo muaj, në varësi të fazës dhe natyrës së marrëdhënies mentoruese. Mund të nevojitet kontakt dhe monitorim më i shpeshtë gjatë fazave të hershme të përzgjedhjes, ose nëse mendohet se një marrëdhënie mentorimi rrezikon të përfundojë përpara kohe. Gjatë vlerësimit të fillimit të marrëdhënies mentoruese, kërkohet shqyrtimi i dosjeve të rastit.

Supervizimi dhe kujdesi për veten

Mentorimi i viktimave të trafikimit mund të jetë shumë i mundimshëm nga pikëpamja emocionale dhe psikologjike. Zakonisht, të mentoruarit u shpalosin mentorëve informacion mjaft personal dhe për këtë arsye mund ta kenë të vështirë t'i menaxhojnë përvojat shqetësuese të cilat i kanë bërë të vuajnë të mentoruarit e tyre. Ekspozimi i përsëritur mund të kontribuojë edhe në përjetimin e traumave të të tjerëve. Prandaj, ka shumë rëndësi që mentorët të vendosin dhe të ruajnë kufijtë e duhur me viktimën e mentoruar për të parandaluar stresin dhe konsumimin profesional.

Menaxherët e rastit dhe organizatat që zbatojnë programe mentorimi duhet t'i supervizojnë dhe mbështesin mentorët përmes diskutimit dhe trajtimit të situatave të vështira dhe ofrimit të ndihmës për të kapërcyer proceset dhe përvojat e vështira me të cilat po ndeshen. Mentorët duhet të nxiten që të shkëputen nga këto diskutime dhe të fokusohen në gjëra të tjera si mënyrë për t'u kujdesur për veten. Mentorët ish viktima do të jenë veçanërisht në nevojë për mbështetje dhe për t'u kujdesur për veten.

“ Gjatë përvojës sime si mentor jam përballur me shumë sfida gjatë punës me të mentoruarit. Historitë që më kanë treguar të mentoruarit dhe vështirësitë që kanë kaluar kanë qenë shumë të dhimbshme dhe të vështira për t'u kapërdirë. Më ka ndihmuar shumë fakti se sfidat dhe emocionet që kam përjetuar lidhur me historitë e të mentoruarve i kam ndarë edhe me mentorët e tjerë gjatë mbledhjeve, si dhe me supervisorin dhe menaxherin e rastit përkatës. Kjo më ka bërë të ndjej se të tjerët më kuptojnë dhe më mbështesin emocionalisht dhe psikologjikisht. (Mentor)

Gjatë trajnimit për mentorim, por edhe gjatë supervizimit të mentorimit, organizatat/institucionet duhet të theksojnë rëndësinë e vetëkujdesit dhe krijimit të një kulture ku vetëkujdesi të diskutohet dhe t'i jepet përparësi.

Krijimi i marrëdhënies së mentorimit

Marrëdhëniet mentoruese mund të krijojnë vlera të reja dhe t'i japin kuptim të ri jetës së viktimave. Megjithatë, kur marrëdhëniet mentoruese nuk janë efikase ose mbështetëse, por përfundojnë krejt befasisht, ka rrezik që viktimat të lëndohen. Krijimi i një marrëdhënieje mentoruese kërkon angazhim dhe investim si nga mentori, ashtu edhe nga i mentoruari, por edhe nga organizatat që zbatojnë programe mentorimi. Ka shumë rëndësi që mentori dhe i mentoruari të dinë se çdo të thotë kjo dhe të jenë të përgatitur për këtë marrëdhënie. Për më tepër, është sërish po aq e rëndësishme që organizata të zotërojë sisteme të përshtatshme për krijimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e marrëdhënies mentoruese.

Disa viktimat trafikimi mund të përfitojnë në mënyrë të veçantë nga marrëdhëniet mentoruese dhe ka shumë rëndësi që t'i angazhohen ato në mënyrë proaktive dhe, nëse dëshirojnë të marrin pjesë, të siguroheni që mentorët të jenë të përgatitur për të plotësuar nevojat e tyre dhe të jenë të trajnuar si duhet për të mentoruar viktimat me përvoja dhe identitete të ndryshme.

Ka pesë hapa kryesorë për të vendosur një marrëdhënie mentorimi: Ato janë:

- **Identifikimi i të mentoruarve**
- **Përzgjedhja e mentorëve**
- **Përgatjtja e mentorëve**
- **Përshtatja e mentorit me të mentoruarin**
- **Menaxhimi i marrëdhënies së mentorimit**

Identifikimi i të mentoruarve

Për çdo program mentorimi ka shumë rëndësi interesi dhe angazhimi i viktimës së trafikimit, pra i të mentoruarit. Të mentoruarit duhet ta konsiderojnë këtë marrëdhënie si të vyer dhe të jenë të gatshëm të angazhohen dhe t'i kushtojnë kohë kësaj marrëdhënieje dhe identifikimit të qëllimeve dhe pjesëmarrjes në aktivitete që synojnë arritjen e këtyre qëllimeve. Që një i mentoruar të ndihet gati për t'u përfshirë në një marrëdhënie mentoruese duhet fillimisht ta kuptojë programin e mentorimit (përfitimet si dhe pritshmëritë) dhe të bjerë dakord me këto kushte/kërkesa. Zakonisht, kjo bëhet përmes një kërkesë me shkrim ku shprehet interesi dhe qëllimet e marrëdhënies mentoruese, si dhe formularit të pëlqimit (ose i miratimit në rastin e fëmijëve dhe të rinjve).¹⁸

Për të vlerësuar “gatishmërinë e të mentoruarit“ duhet të shikojmë nëse i/e mentoruara:

- është i/e qartë dhe bie dakord për nivelin e angazhimit që kërkohet për marrëdhënien mentoruese (përfshi shpeshësinë e kontaktit dhe kohëzgjatjen e marrëdhënies)
- është mendërisht ose emocionalisht i/e gatshëm të përfshihet në marrëdhënie mentoruese (disa mund të jenë në një fazë të tillë që nuk mendojnë se mentori është i rëndësishëm për jetën dhe nevojat e tyre)¹⁹

Ka shumë rëndësi që të ofrohen edhe orientime ose trajnime për të mentoruarit, ku t'u shpjegohet programi i mentorimit (qëllimi dhe procesi), rregullat, kërkesat dhe kufijtë, pritshmëritë e të mentoruarve dhe mentorëve dhe si do të mbikëqyret marrëdhëniet. Në këto seanca orientimesh ose trajnimesh, të mentoruarit mund të bëjnë pyetje ose të shprehin shqetësimet e tyre. Kjo gjë i ndihmon

¹⁸Youth Collaboratory (2021) *Dritëdhedhje mbi Shfrytëzimin seksual të Fëmijëve për Qëllime Tregtare: Paketë Mjetesh për të Kuptuar më Mirë*. Shtetet e Bashkuara Youth Collaboratory, OJJDP dhe Qendra për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Universitetin e Whichita-s.

¹⁹DuBois, D. and J. Felner(2016) *Mentoring for youth with backgrounds of involvement in commercial sex activity*. Boston: National Mentoring Resource Center.

të mentoruarit që të jenë plotësisht të informuar dhe të përgatitur për t'u përfshirë në programin e mentorimit dhe në marrëdhënien mentoruese.²⁰

Të mentoruarit duhen orientuar edhe për çështjet etike dhe të sigurisë, për të garantuar pasjen e mjeteve dhe burimeve të nevojshme për t'u ndjerë sa më rehat në marrëdhënien mentoruese. Këtu përfshihen:

- ✓ Kufijtë e arsyeshëm të kontaktit fizik dhe marrëdhënies
- ✓ Detajet e kontaktit në rast emergjence, përfshi edhe se kush duhet kontaktuar nga programi nëse i mentoruari ka pyetje ose shqetësime
- ✓ Konfidencialiteti dhe privatësia, si dhe konfidencialiteti i kufizuar
- ✓ Kërkesat e raportimit të detyrueshëm
- ✓ Përdorimi i mediave digjitale dhe sociale
- ✓ Llojet e takimeve të mentorëve/të mentoruarve dhe aktiviteteve të miratuara
- ✓ Politikat e transportit²¹

Përzgjedhja e mentorëve

Mentorët duhet të jenë të përgatitur që të marrin përsipër përgjegjësitë që vijnë së bashku me praninë e tyre në jetën e të mentoruarit. Mospërmbyshja e këtyre angazhimeve mund të ketë efekt shkatërrimtar te i mentoruari, i cili nuk ka përvojë me marrëdhëniet e shëndetshme dhe mbështetëse dhe mund të ketë pësuar shumë zhgënjime dhe braktisje gjatë jetës.

Përzgjedhja e mentorëve të përshtatshëm duhet të mbështetet te kualifikimet e mentorëve. Këto kualifikime janë:

- ✓ Përvojë dhe mençuri të cilat mund të ndahen me të mentoruarin
- ✓ Përkushtim në marrëdhënien mentoruese me kalimin e kohës
- ✓ Interes për të mentoruarin dhe përmirësimin e jetës së tij/saj
- ✓ Fleksibilitet dhe mirëkuptim për këndvështrimet e tyre
- ✓ Përshtatje me nevojat e të mentoruarit
- ✓ Aftësi të mira komunikimi dhe sociale
- ✓ Motivim për shërbimin e të mentoruarit
- ✓ Përgjegjësi dhe përgjegjshmëri
- ✓ Mbështetës dhe bashkëpunues me të mentoruarin dhe me ekipin

Në përzgjedhjen e mentorëve, është gjithashtu e rëndësishme që ata të përputhen me viktimat e mentoruara. Pra, duhet të zgjedhim mentor mashkull për viktimat meshkuj dhe mentore femra për viktimat femra. Mundet edhe të zgjidhen mentorë që identifikohen si LGBTQ+ të cilët mund të jenë shembuj mjaft pozitivë për të rinjtë LGBTQ+, t'i kuptojnë më mirë përvojat e tyre në jetë dhe të sigurohen që organizata të ofrojë mjedise miqësore për LGBTQ+. Ka shumë rëndësi që mentorët të vlerësohen për të identifikuar të gjithë ata që kanë qasje apo vlera të cilat nuk janë në përputhje me qasjen jodiskriminuese.

²⁰Youth Collaboratory (2021) *Dritëhedhje mbi Shfrytëzimin seksual të Fëmijëve për Qëllime Tregtare: Paketë Mjetesh për të Kuptuar më Mirë*. Shtetet e Bashkuara Youth Collaboratory, OJJDP dhe Qendra për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Universitetin e Whichita-s. Shihni edhe Garringer, M., J. Kupersmidt, J. Rhodes, R. Stelter dhe T. Tai (2015) *Elementet e Praktikimit Efikas të Mentorimit*. Boston: MENTOR.

²¹Youth Collaboratory (2021) *Dritëhedhje mbi Shfrytëzimin seksual të Fëmijëve për Qëllime Tregtare: Paketë Mjetesh për të Kuptuar më Mirë*. Shtetet e Bashkuara Youth Collaboratory, OJJDP dhe Qendra për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Universitetin e Whichita-s.

Mentorët ish-viktima duhet t'i kenë të gjitha kualifikimet si mentorë. Krahas kësaj, ata duhet ta kenë përfunduar me sukses riintegrimin e tyre, përfshi këtu punësimin e qëndrueshëm, mjedisin e shëndetshëm social, mirëqenien fizike dhe psikologjike, si dhe angazhimin dhe interesin për të ndihmuar të tjerët. Ka shumë rëndësi që mentorët të mos kenë tregues të tillë që roli i tyre si mentor ish-viktima të mund të jetë ritraumatizues.

Ka gjithashtu shumë rëndësi që të përcaktohen kërkesat për vetë rolin e mentorit (p.sh pritshmëritë e programit të mentorimit, trajnimi i kërkuar, natyra dhe shpeshësia e mbledhjeve të mentorimit, koha minimale e angazhimit javor, periudha minimale e angazhimit për rolin mentorues).

Përzgjedhja mund të ndodhë nëpërmjet kërkesës me shkrim dhe/ose intervistave ballë për ballë të cilat japin informacione të mjaftueshme për të vlerësuar sigurinë dhe përshtatshmërinë e mentorit, por edhe gatishmërinë e tij bazuar në kualifikime dhe kriteret. Jo të gjithë që kërkojnë të bëhen mentorë i kanë cilësitë e nevojshme për të qenë të suksesshëm, sidomos kur bëhet fjalë për të punuar me viktimat e trafikimit. Përshtatshmëria midis mentorit dhe të mentoruarit kërkon kohë dhe kujdes.

Mentorët e mundshëm duhen vlerësuar dhe validuar, përfshi këtu kontrollin e identitetit, referencave, dëshmisë së penalitetit (përfshi bazën e të dhënave të abuzuesve me fëmijët dhe abuzuesit seksualë) e kështu me radhë. Në rastin e mentorëve ish-viktima, duhen marrë parasysh elemente shtesë si p.sh akuzat penale që i kualifikojnë ose i skualifikojnë ata si mentorë pasi shumë viktima trafikimi kanë rekorde kriminale (p.sh për prostitucion, migrim të parregullt) si pasojë e drejtpërdrejtë e trafikimit.

Përgatitja e mentorëve

Pasi përzgjidhen dhe vlerësohen, mentorët duhen trajnuar për ta përmbushur rolin me sukses dhe për t'i mbështetur si duhet të mentoruarit gjatë ecurisë së marrëdhënies mentoruese, ku do të ofrohet mbështetje dhe mbikëqyrje e mëtejshme sipas nevojës. Orientimi dhe trajnimi duhet të mbulojnë një sërë temash dhe çështjesh, si:²²

- Të kuptuarit e nevojave të viktimës së trafikuar dhe rrugëve të riintegritit, përfshijnë:
 - Ndikimin e traumës dhe mënyrës se si duhen zbatuar praktikatat e bazuara në traumë.
 - Përgjigjet traumatike ndaj shfrytëzimit për trafikim dhe cenueshmërive ekzistuese në jetën e tyre
 - Cenueshmëritë dhe mundësitë për rikuperimin e viktimave të trafikimit
 - Profilet e ndryshme të viktimave të trafikuar duke përfshirë gjininë, identitetin seksual, moshën, etj.
- Rolet dhe përgjegjësitë në marrëdhënien mentor-i mentoruar janë:
 - Përgjegjësia e mentorit kundrejt viktimës së mentoruar dhe prindërve ose kujdestarit të tyre ligjor, përfshirë edhe përgjegjësitë lidhur me shëndetin dhe sigurinë
 - Përgjegjësia e mentorit për organizatën
 - Përgjegjësia e organizatës për mentorin
 - Pritshmëritë realiste për marrëdhënien mentoruese
- Praktikatat e mira të mentorimit janë:
 - Si të mbështesim të mentoruarit për të kuptuar dhe përcaktuar qëllimet e tyre

²²Countryman-Roswurm, K. (2015) 'Ngrihuni, bashkohuni, mbështesni: Të mos lëndosh, kjo është lëvizja e re kundër trafikimit *Slavery Today Journal*, 2(1);; Countryman-Roswurm, K. dhe B. Patton Brackin(2017) "Ndërgjegjësim pa rishfrytëzim: Fuqizimi i qasjeve për përcjelljen e mesazheve rreth trafikimit të qenieve njerëzore", *Journal of Human Trafficking*; dhe Youth Collaboratory (2021) *Dritëdhjetë mbi Shfrytëzimin seksual të Fëmijëve për Qëllime Tregtare: Paketë Mjetesh për të Kuptuar më Mirë*. Shtetet e Bashkuara Youth Collaboratory, OJJDP dhe Qendra për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Universitetin e Whichita-s.

- Aftësitë e mira të komunikimit dhe të dëgjuarit aktiv, përfshirë edhe përdorimin e gjuhës fuqizuese dhe motivuese
 - Krijimi i marrëdhënieve dhe i besimit
 - Ndërgjegjësimi dhe ndjeshmëria ndaj diversitetit dhe kulturave të ndryshme
 - Përcaktimi i kufijve të përshtatshëm dhe i limiteve me të mentoruarit dhe familjarët e tyre
 - Nxitja e transparencës dhe komunikimit të hapur lidhur me pritshmëritë
 - Të qenit i hapur ndaj sugjerimeve dhe pranimit të faktit se mentori mund të mos ketë gjithnjë të drejtë
 - Vetëreflektimi dhe sfidimi i këndvështrimeve dhe supozimeve
- Kodi i Sjelljes dhe rregullat etike për marrëdhënien mentoruese janë:
 - Mos lëndo
 - Ruaj konfidencialitetin dhe privatësinë e të mentoruarit (përveç se ku ka situata me rrezik i mentoruari ose të tjerët mund të dëmtohen)
 - Kërkesat e raportimit të detyrueshëm
 - Respektimi i të drejtave dhe dinjitetit të të mentoruarit
 - Trajtimi i drejtë dhe i arsyeshëm i të gjithë të mentoruarve
 - Interesi më i lartë i të mentoruarit
 - Siguria dhe rreziku për dëm të mëtejshëm

Është shumë e rëndësishme që e gjithë kjo përmbajtje të përfshihet në një doracak të cilin mentorët ta mbajnë gjithnjë me vete dhe ta përdorin si burim gjatë punës së tyre. Doracaku duhet të përfshijë edhe kopje të të gjitha politikave dhe procedurave të programit dhe detajet e kontaktit në rast emergjence për kriza që mund të ndodhin pas disa orësh.

Mentorët duhet të mbështeten dhe supervizohen vazhdimisht në mënyrë që ta dinë se nuk janë vetëm dhe se nuk pritët t'i kenë të gjitha përgjigjet. E gjitha kjo mund të arrihet përmes ndërveprimeve ballë për ballë dhe seancave mbështetëse nga mentorët ish-viktima, përmes së cilave mentorët mund të ndajnë përvojat e tyre, të mësojnë nga njëri-tjetri dhe të nxisin punën mentoruese të gjithsecilit.²³

Përputhja midis mentorëve dhe të mentoruarve

Përputhja /pështatja bëhet në bazë të pikave të forta, nevojave, preferencave dhe interesave të mentorëve dhe përfituesve të shërbimit. Disa prej kriterëve të pështatjes janë:

- Gjinia
- Raca dhe etnia
- Kultura
- Nevojat e veçanta si vështirësitë në të nxënë, aftësia e kufizuar fizike, ose vështirësitë emocionale dhe sjellore.
- Afërsia gjeografike
- Personaliteti dhe temperament
- Interesat e përbashkëta dhe aktivitetet e preferuara
- Pikat e forta
- Karakteristikat demografike

Menaxheri i rastit e ndihmon viktimën e mentoruar të kuptojë rolin e mentorit dhe merr pëlqimin e tij/saj me shkrim për mentorin e propozuar. Në rastin e fëmijëve, të rinjve ose të rriturve të varur, janë

²³Youth Collaboratory (2021) *Dritëhedhje mbi Shfrytëzimin seksual të Fëmijëve për Qëllime Tregtare: Paketë Mjetesh për të Kuptuar më Mirë*. Shtetet e Bashkuara Youth Collaboratory, OJJDP dhe Qendra për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Universitetin e Whichita-s.

prindërit ose kujdestarët ligjorë ata që japin pëlqimin për përzgjedhjen e mentorit dhe vendosjen e qëllimeve të marrëdhënies.

Të mentoruarit përgatiten për atë që mund të presin nga programi dhe marrëdhënia mentoruese dhe për atë që pritet prej tyre për sa i përket angazhimit dhe përkushtimit të tyre në marrëdhënie. Mentorët marrin informacionet përkatëse rreth personit me të cilin do të punojnë, përpara se ta takojnë personin.

Menaxherët e rastit ngarkohen të mbikëqyrin marrëdhënien dhe të krijojnë dosjen e rastit për çdo mentor dhe të mentoruar. Kjo përfshin: informacione të përmbledhura rreth mentorit dhe të mentoruarit gjatë vlerësimit dhe përzgjedhjes, evidencat e të gjitha mbledhjeve të zhvilluara midis mentorit dhe të mentoruarit duke përfshirë prindërit dhe kujdestarët ligjorë, si dhe evidencat për të gjitha aktivitetet e zhvilluara në çdo mbledhje mentoruese.

Menaxhimi i marrëdhënies së mentorimit

Mentorët janë figura mjaft të rëndësishme në jetën e viktimës së mentoruar. Ka shumë rëndësi që mentorimi të jetë pikësëpari një marrëdhënie sa më mbështetëse, e dobishme dhe pozitive. Por si me çdo marrëdhënie, marrëdhënia mentoruese mund të hasë mjaft pengesa dhe mendime të kundërta. I mentoruari dhe mentori duhet të gjejnë vullnetin të punojnë për kapërcimin e këtyre pengesave dhe të përpiqen të krijojnë një marrëdhënie sa më të besueshme dhe të shëndetshme.

Nëse viktimja e mentoruar nuk është i/e lumtur ose i/e kënaqur me marrëdhënien, ka shumë rëndësi që kjo gjë të diskutohet midis mentorit dhe të mentoruarit, si dhe midis mentorit dhe menaxherit të rastit. Kjo mund të ndodhë kur:

- I/e mentoruari/a dhe mentori/ja nuk kanë durim
- I/e mentoruari/a dhe mentori/ja nuk përshtaten bashkë
- Përvojat e kaluara të të mentoruarit mund ta vështirësojnë përfshirjen e tyre të plotë në një marrëdhënie mbështetëse
- I/e mentoruari/a nuk ka besim, qoftë edhe pas disa kohësh
- I/e mentoruari/a mendon se mentori/ja është dikush të cilit/cilës nuk mund t'i besojnë dhe që ndan informacion me të tjerët
- I/e mentoruari/a refuzon vazhdimisht të përfshihet në marrëdhënie të reja, për shkak të traumës
- I/e mentoruari/a përpiqet t'i kalojë kufijtë e marrëdhënies mentoruese dhe të kërkojë më tepër nga mentori/ja
- I/e mentoruari/a nuk kënaqet te aktivitetet që zhvillohen ose nuk ndjehet rehat me marrëdhënien

Në disa raste, mentori/ja mund të mos jetë i/e kënaqur me marrëdhënien që ka me të mentoruarin. Kjo mund të ndodhë kur:

- Mentori/ja inatohet ose nuk ndjehet rehat me sjelljen e përfituesit
- Nuk ka bashkëpunim gjatë hartimit të planit sepse i/e mentoruari/a nuk është i/e angazhuar në proces
- I/e mentoruari/a nuk është i/e përpiktë me orarin në takime
- I/e mentoruari/a nuk i respekton kufijtë dhe rregullat e marrëdhënies mentoruese dhe kërkon favore personale

Në këto raste, mentori/ja duhet t'i shprehë ndjenjat dhe të diskutojë me menaxherin e rastit dhe mbikëqyrësin. Mentori/ja duhet të ketë informacion edhe për traumat dhe të dijë se si t'u përgjigjet atyre, në mënyrë që ta kuptojë dhe ta menaxhojë më mirë sjelljen e viktimës. Ka shumë rëndësi që mentori/ja të diskutojë me të mentoruarin/ën edhe ato gjëra që nuk shkojnë ashtu si duhet në

marrëdhënie. Nëpërmjet procesit të ndarjes apo diskutimit, të mentoruarit i jepet mundësia që të shprehë ankesat ose gjërat që kanë nevojë për përmirësim.

Nëse mentori/ja ose i/e mentoruari/a nuk ndihet rehat me marrëdhënien, atëherë kjo marrëdhënie nuk është më e vlefshme dhe mund të vazhdojë të mos jetë e tillë deri kur situata të rishikohet. Në disa raste, mund të jetë e nevojshme që t'i jepet fund marrëdhënies mentor – i/e mentoruar. Kjo ndodh kur:

- Takimet nuk i arrijnë objektivat për një kohë të gjatë
- Komunikimi midis mentorit dhe të mentoruarit nuk është i mirë dhe sjell keqkuptime
- Kur mentori/ja ose i/e mentoruari/a shpreh dëshirën për t'i dhënë fund marrëdhënies.

Lara²⁴ ra dakord të përfshihej në një marrëdhënie mentoruese dhe në fillim ishte shumë e kënaqur me këtë lloj mbështetjeje. Maja ishte mentore vërtetë shumë mbështetëse dhe Lara ndihej mirë me marrëdhënien. Por, pas rreth katër muajsh, ajo filloi të shprehte pakënaqësi rreth marrëdhënies me mentoren. Lara ishte e mërzhitur për faktin se Maja punonte edhe me të mentoruar të tjerë. Kjo e bënte të ndihej xhelozë dhe e trishtuar. Lara dhe Maja diskutuan gjërë e gjatë rreth këtyre ndjenjave dhe Maja i shpjegoi Larës se marrëdhënia mentoruese është unike dhe e veçantë. Lara e pranoi më në fund faktin se ndonëse njerëzit (përfshi edhe Maja) krijojnë marrëdhënie me persona të ndryshëm, kjo nuk do të thotë se marrëdhënia që kanë me të është më pak e rëndësishme. Lara arriti ta pranonte këtë fakt dhe filloi ta vlerësonte sërish marrëdhënien mentoruese me Majën.


²⁴ Të gjithë emrat janë ndryshuar për të mbrojtur privatësinë e individëve të përfshirë.

Faza të ndryshme të marrëdhënies së mentorimit²⁵

Marrëdhëniet e mentorimit në përgjithësi fillojnë në fazën tranzitore të riintegrit (nga 7 – 12 muaj). Në këtë periudhë, i/e mentoruari/a kupton rolin e një mentori dhe është në gjendje të vendosë nëse është diçka që mund të jetë e dobishme për ta në rimëkëmbjen dhe riintegrimin e tyre.

Mentorimi në mënyrë ideale funksionon për një periudhë prej të paktën një viti. Dhe mentori duhet të jetë i përgatitur që t'i kushtojë kohën e duhur krijimit të një marrëdhënieje besimi me përfituesin. Megjithatë, nuk ka asnjë formulë strikte për përcaktimin e periudhës kohore të çdo faze. Disa marrëdhënie mentorimi zgjasin më shumë në varësi të vullnetit të dy palëve. Edhe kur një marrëdhënie mentorimi ka përfunduar, ka mundësi që kjo marrëdhënie të vazhdojë në një mënyrë më pak formale. Në raste të tjera, koha që i nevojitet personit për të qëndruar në mentorim është më e shkurtër dhe e drejtuar drejt objektivave më të qarta.

Katër fazat kryesore të marrëdhënies së mentorimit janë:



Faza e parë: Ndërtimi i marrëdhënies mentor/i mentoruar (1



Fokusi në këtë fazë është krijimi i një marrëdhënieje besimi dhe respekti midis mentorit dhe të mentoruarit. Gjithashtu në këtë fazë prezantohet dhe caktohet natyra e marrëdhënies. Të dyja palët duhet të jenë të vetëdijshme për rolet dhe përgjegjësitë e tyre, si dhe për kufijtë e marrëdhënies.

Mentorët si fillim kërkojnë të njohin të mentoruarin, tregojnë interes, i ftojnë ata të ndajnë informacione për veten e tyre, duke përfshirë shpresat dhe pritshmëritë nga programi i mentorimit. Është e rëndësishme që në takimet e hershme, mentorët gjithashtu të ndajnë përvojën dhe interesat e tyre në mënyrë që të mentoruarit të kenë një kuptim më të qartë se kush është mentori i tyre si person dhe njohuria, përvoja dhe ekspertiza që ata sjellin në marrëdhënie. Është gjithashtu e rëndësishme që mentorët të ndajnë pritshmëritë dhe aspiratat e tyre për rolin e tyre.

Kjo fazë përfshin fillimin e ndërtimit të sigurisë dhe besimit. Krijimi i një marrëdhënie besimi mund të kërkojë gjëra të ndryshme për përfitues të ndryshëm, të cilët në përgjithësi kanë ndjenja pasigurie. Ajo që ndihmon ndërtimin e besimit përfshin gadishmërinë e mentorit për të qenë pranues dhe i hapur me të mentoruarin, jo për të qenë gjykatës apo për të këmbëngulur se cila është mënyra e drejtë apo e

²⁵D&E and KMOP (2019) *Trainimi mbi Mentorimin – Mbështetja bashkëmoshatare*. Tiranë: Të Ndryshëm dhe Të Barabartë, Athinë: Qendra për Inovacion dhe Veprim Social (KMOP), f. 7-11.

gabuar për të bërë diçka. Ndërtimi i besimit përfshin gjithashtu që mentorët të jenë të qëndrueshëm, të pranishëm, empatikë, të kujdesshëm dhe të respektueshëm. Është e rëndësishme që mentorët të shpjegojnë gjithashtu parimet që mbështesin punën si mentor, duke përfshirë faktin se i gjithë informacioni i ndarë është konfidencial, përveç rasteve kur paraqet rrezik për dëmtimin e të mentoruarit ose të tjerëve.

Të mentoruarit duhet t'i jepet koha e nevojshme për të kapërcyer frikën, dyshimet, pasiguritë që mund të shoqërojnë fillimin e një marrëdhënieje të re. Ndërtimi i besimit kërkon kohë dhe nuk duhet të nxitohet. Ai është themeli i marrëdhënies së mentorimit.

Viktimat e trafikimit kanë qenë të ekspozuar ndaj dhunës dhe ngjarjeve traumatike dhe mund të kenë nevojë për kohë shtesë për të krijuar marrëdhënie besimi. Një i mentoruar mund të jetë hezitues ose dyshues për krijimin e një lidhjeje me një mentor dhe mund ta "testojë" marrëdhënien për të parë nëse mentori do t'i zhgënjë ose do t'i braktisë siç mund të kenë bërë të tjerët në jetën e tyre. Është e rëndësishme të njihen këto sjellje si mekanizma të përballimit dhe të mbijetesës dhe jo si armiqësi, refuzim ose "veprim". Procesi fillestar i marrëdhënies do të marrë kohë dhe kërkon durim ²⁶.

Është e dobishme që në fillim të jeni të qartë për qëllimin dhe strukturën e takimeve të mentorimit. Është gjithashtu në këtë fazë të hershme kur mentorët dhe të mentoruarit do të arrijnë një marrëveshje se si do të organizohet puna së bashku – d.m.th. sa shpesh do të takohen dhe komunikojnë, në çfarë formati dhe ku, etj. Frekuenca e takimeve varet nga nevojat e të mentoruarit, si dhe nga disponueshmëria e mentorit ose të mentoruarit. Në përgjithësi takimet në këtë fazë duhet të jenë të paktën një herë në javë.

“Maria” është viktimë e trafikimit, e cila është mentoruar prej rreth një viti. Maria ishte 18 vjeç kur nisi procesi i mentorimit. Ideja e një mentoreje iu prezantua fillimisht Marias nga menaxherja e rastit të saj dhe ajo ishte entuziaste për të pasur një mentore. Takimi i parë u organizua në prani të menaxherit të rastit dhe Maria u prezantua me mentoren e saj “Suzana”. Gjatë fazës së parë, Suzana dhe Maria kaluan kohë së bashku për të krijuar marrëdhënien e tyre duke përfshirë rregullat dhe përgjegjësitë dhe për të mësuar se si t'i besojnë njëra-tjetrës. Gjatë javëve në vijim, marrëdhënia mes Suzanës dhe Marisë u bë më e ngushtë dhe Maria tregoi më shumë për jetën e saj dhe u përfshi më shumë në aktivitetet.

Faza e dytë: Shkëmbimi i përvojave dhe vendosja e qëllimeve (1 - 2



Rasi krijohet marrëdhënia mentor/i mentoruar, mentori dhe i mentoruari do ta ndërtojnë më tej atë marrëdhënie duke kaluar kohë së bashku dhe duke mësuar më shumë për njëri-tjetrin. Kjo do t'i ofrojë mentorit njohuri për përvojat e të mentoruarit, si dhe për qëllimet e ardhshme. Është e rëndësishme të angazhoheni dhe të dëgjoni në mënyrë aktive të mentoruarin dhe të punoni me të për të vendosur synime për të ardhmen. Qëllimet e ndihmojnë të mentoruarin të shohë përtej çështjeve dhe sfidave të përditshme dhe të ketë një "destinacion" për të ecur drejt. Kur vendosni qëllime, është shumë e rëndësishme t'i ndani objektivat në hapa të vegjël dhe të menaxhueshëm.

²⁶MENTOR and MHA-NYC (2009) *Supporting Young People in the Wake of Violence and Trauma*. Boston: MENTORI dhe Nju Jorku: Shoqata për Shëndetin Mendor, Nju Jork, f.4-5.

Mentorët duhet të jenë mbështetës dhe inkurajues në këtë proces, duke inkurajuar të mentoruarit të diskutojnë për qëllimet e tyre. Mentorët duhet ta udhëzojnë të mentoruarin që t'i referohet qëllimeve të tij periodikisht si një mënyrë për të rifokusuar qëllimet dhe për të matur progresin. Referimi i qëllimeve rregullisht është gjithashtu një mënyrë e mirë për mentorët që të dinë nëse po i ndihmojnë të mentoruarit për të arritur këto qëllime dhe, nëse jo, çfarë më shumë duhet të bëjnë për të mbështetur të mentoruarit në këtë proces.

Objektivat mund të përfshijnë:

- ✓ Ndërtimi i aftësive në zgjidhjen e problemeve
- ✓ Zhvillim personal
- ✓ Krijimi i aftësive efektive të komunikimit
- ✓ Rritja e vetëbesimit dhe vetëbesimit
- ✓ Rritja e aksesit në burimet e tjera të disponueshme
- ✓ Rritja e aftësive për të shmangur shfrytëzimin, ose për të shmangur marrëdhëniet e dëmshme personale
- ✓ Krijimi i një rrjeti social të sigurt dhe pozitiv
- ✓ Rritja e aftësive për tregun e punës
- ✓ Rritja e njohurive kulturore
- ✓ Përmirësimi i performancës në shkollë ose në punë
- ✓ Aftësi e përmirësuar për të përballuar situatat stresuese dhe për të menaxhuar emocionet

Aktivitetet dhe ndërveprimet ndryshojnë sipas të mentoruarit dhe çdo marrëdhënie mentorimi. Disa aktivitete mund të kenë qëllime edukimi ose informimi, ndërkohë që në disa raste kanë qëllim relaksues, eksplorues. Aktivitetet kryhen kryesisht në baza javore, të vendosura paraprakisht nga mentori dhe i mentoruari.



Ajo që do të më mungojë nga mentorimi është të dal, të shkoj në kinema. Ishte hera ime e parë në kinema, kaq emocionuese. (E mentoruar dhe ish-viktimë trafikimi)



Aktivitetet kryesisht organizohen në baza individuale, por mund të ketë disa aktivitete specifike që organizohen në grup. Zgjedhja e aktiviteteve bëhet në bashkëpunim me të mentoruarin, në varësi të moshës, gjinisë, interesave e kështu me radhë. Këto mund të përfshijnë:

- Vajtja në kinema dhe teatër
- Vizita në muze dhe galeri
- Shëtitjet dhe ecjet me biçikletë
- Aktivitete sportive dhe fizike (vetëmbrojtje, joga)
- Vajtja në kafene, restorante dhe piknik
- Kurse të gjuhëve të huaja
- Aktivitete fetare, si frekuentimi i kishës dhe xhamisë
- Kujdesi për veten
- Praktika në përgatitjen për punë (p.sh. kërkimi i punës, përgatitja e CV-së, trajnimi për intervista pune)
- Kujdesi për të tjerët dhe kontributi në shoqëri (p.sh. aktivitete bamirësie)
- Të shijuarit e natyrës përmes aktiviteteve (p.sh. mbjellja e një peme, të qenit në natyrë)

Djemtë dhe burrat priren të lidhen dhe të mësojnë më mirë përmes veprimeve ose ndërveprimeve të bazuara në argëtim, në vend të aktiviteteve verbale – p.sh. aktivitete fizike ose praktike. Edhe pasi krijohet një marrëdhënie besimi, në vend që të hapen përmes bisedës, meshkujt shpesh e kanë më të lehtë të flasin ndërsa janë duke kryer një aktivitet tjetër. Mentorët mund të modelojnë manifestime më pak konvencionale të maskulinitetit në të cilat është e pranueshme të shprehësh emocione, të zbulosh dobësitë dhe të marrësh mbështetje.²⁷

Nga ana tjetër, vajzat nga natyra janë të fokusuara në marrëdhënie, çka do të thotë se marrëdhëniet mund të ndikojnë veçanërisht në zhvillimin e tyre. Vajzat përfitojnë maksimumin nga mentorimi kur ndihen rehat për të folur me mentoret e tyre. Marrëdhëniet e këshillimit femër-femër ofrojnë një nivel më të madh miqësie, këshillimi dhe mbështetjeje personale sesa kombinimet e tjera gjinore.²⁸

Në të njëjtën kohë, një histori traume mund të pengojë aftësinë për t'u afruar në fazat e hershme të marrëdhënies së mentorimit. Mund të duhet kohë që të mentoruarit, veçanërisht femrat, të krijojnë lidhje besimi. Marrëdhëniet e këshillimit femër-femër ofrojnë një nivel më të madh miqësie, këshillimi dhe mbështetjeje personale sesa kombinimet e tjera gjinore²⁹.

“ Ndryshe nga vajzat që pëlqejnë të flasin dhjetë shijojnë një kafe me mentoren, djemtë janë më të interesuar për aktivitete fizike, fitnes apo për të luajtur futboll dhe jo aq shumë për të folur e diskutuarpëraspektedhe apo çështje të ndryshme.

(Menaxher rasti)

Në këtë fazë të re marrëdhënies së tyre mentoruese, Maria dhe Suzana u fokusuan te çështje, objektiva dhe qëllime konkrete. Maria kishte nevojë të zgjeronte rrethin miqësor, të krijonte marrëdhënie me familjarët, të angazhohej në marrëdhënie të shëndetshme dhe të punonte me aftësitë e saj të komunikimit dhe menaxhimit të mullerit. Për të trajtuar nevojën e zgjerimit të rrjetit dhe aftësive sociale, Maria dhe Suzana vendosën se Marias do t'i bënte mirë të mësonte një gjuhë të huaj. Kështu Maria u fut në një kurs për gjuhë të huaj. Gjithashtu u vendos që asaj do t'i bënte mirë të gjente një punë me kohë të pjesshme, të përmirësonte aftësitë e saj sociale dhe të komunikimit, si dhe të fitonte aftësi të reja dhe përvojë gjatë riintegrit të saj afatgjatë.

Faza e tretë: Puna drejt qëllimeve dhe thellimi i angazhimit (afërsisht 9 muaj)

Kjo është, më së shpeshti, periudha më e gjatë e marrëdhënies së mentorimit. Pikërisht në këtë periudhë i mentoruari punon drejt arritjes së qëllimeve të tij. Arritja e qëllimeve bëhet përmes takimeve dhe bisedave të rregullta për tema të zgjedhura nga i mentoruari që drejton këto diskutime. Mentori është aty për të dëgjuar gjithçka që e konsideron të rëndësishme dhe dëshiron të ndajë gjatë periudhës së mentorimit. Disa tema të zakonshme përfshijnë:

²⁷Youth Collaboratory (2021) *Dritëdhedhje mbi Shfrytëzimin seksual të Fëmijëve për Qëllime Tregtare: Paketë Mjetesh për të Kuptuar më Mirë*. Shtetet e Bashkuara Youth Collaboratory, OJJDP dhe Qendra për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Universitetin e Whichita-s.

²⁸Youth Collaboratory (2021) *Dritëdhedhje mbi Shfrytëzimin seksual të Fëmijëve për Qëllime Tregtare: Paketë Mjetesh për të Kuptuar më Mirë*. Shtetet e Bashkuara Youth Collaboratory, OJJDP dhe Qendra për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Universitetin e Whichita-s.

²⁹Youth Collaboratory (2021) *Dritëdhedhje mbi Shfrytëzimin seksual të Fëmijëve për Qëllime Tregtare: Paketë Mjetesh për të Kuptuar më Mirë*. Shtetet e Bashkuara Youth Collaboratory, OJJDP dhe Qendra për Luftën kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore në Universitetin e Whichita-s.

- ☼ Mirëqenia personale duke përfshirë gjendjen emocionale të të mentoruarit, shqetësimet dhe ankthet.
- ☼ Situata familjare dhe marrëdhëniet
- ☼ Marrëdhënie të shëndetshme personale
- ☼ Dinamika e shkollës ose e punës dhe trajtimi i situatave të përditshme
- ☼ Objektivat për të ardhmen
- ☼ Koncepti i vetes dhe vetëvlerësimit
- ☼ Përvoja të tjera që i mentoruari zgjedh të ndajë (p.sh. përvojat e kaluara, çështjet familjare, përvojat e trafikimit)

Kjo arrihet gjithashtu nëpërmjet aktiviteteve të të mësuarit dhe zhvillimit, siç janë përmendur në Fazën #2 (më sipër), bazuar në dëshirat dhe interesat e të mentoruarit. Për shembull, nëse qëllimi është rritja e aftësive sociale, i mentoruari mund t'i bashkohet një klubi (klubi librash, grupe të gjuhëve të huaja, organizata kulturore) ku ata do të kenë mundësi të shoqërohen dhe të përmirësojnë aftësitë e tyre sociale. Në mënyrë të ngjashme, nëse qëllimi i të mentoruarit është punësimi, atëherë mentori punon me të mentoruarit për t'i ndihmuar të gjejnë një punë, i inkurajon drejt intervistave të punës, të hartojë një CV së bashku ose të shikojnë së bashku njoftimet për punë. Dhe nëse qëllimi është relaksimi dhe menaxhimi i stresit, aktivitetet do të përfshijnë ato që lehtësojnë stresin dhe që preferohen nga i mentoruari, si aktiviteti fizik, dalja në natyrë ose ndjekja e një kursi jogle.

Vendimet merren së bashku nga mentorët dhe të mentoruarit. Në fillim të çdo muaji, hartohet plani mujor, duke biseduar me të mentoruarin se cilat aktivitete preferon dhe cilat janë qëllimet që do të arrijë.

Kur kryhet me sukses, kjo fazë e mentorimit karakterizohet nga çiltërsia dhe besimi, diskutimi kuptimplotë dhe aplikimi i njohurive dhe qasjeve të reja. Pikërisht në këtë fazë mentorët dhe të mentoruarit do të duhet të reflektojnë se çfarë progresi kanë realizuar drejt qëllimeve të tyre dhe të marrin në konsideratë nëse nevojiten ndryshime në lidhje me këto qëllime.

Në këtë fazë, mentorët dhe të mentoruarit bejnë gjithashtu një reflektim mbi natyrën dhe cilësinë e marrëdhënies dhe procesit të mentorimit duke përfshirë:

- përfitimet e marrëdhënies deri tani
- ndryshimet si rezultat i marrëdhënies së mentorimit
- përshtatjet ose ndryshimet e nevojshme në marrëdhënie

Që takimet e mentorimit të jenë të suksesshme dhe të dobishme, është e rëndësishme të kemi një qëllim dhe strukturë të qartë. Me një marrëveshje për strukturën dhe parametrat kohorë, është e rëndësishme që ata të marrin në konsideratë përmbajtjen e takimeve. Nga njëra anë, është e dobishme të rishikohen përvojat e të mentoruarit dhe nëse ata i kanë arritur qëllimet e tyre. Nga ana tjetër, është gjithashtu e rëndësishme të merren parasysh çështjet aktuale dhe të vendosen synime reale për të ecurpërpara.

Vështirësitë në këtë fazë mund të lindin për shkak të rrethanave të jetës së viktimës-të mentoruarit, pasi ata luftojnë për t'u rikuperuar dhe riintegruar. Megjithatë, mentorimi mund ta ndihmojë viktimën të zgjidhë çështje të ndryshme familjare dhe personale dhe mentori bëhet një marrëdhënie e rëndësishme për të mentoruarin.

Një sfidë është nevoja për të gjetur ekuilibrin e duhur në marrëdhënien mentor- i mentoruar. Ekziston rreziku që një mentor mund të përfshihet shumë me të mentoruarin. I mentoruari gjithashtu mund të bëhet shumë i varur nga mentori.

Mentorët gjithashtu duhet të kuptojnë gamën e reagimeve emocionale që mund të kenë dhe shprehin viktimitat e trafikimit, duke përfshirë shkallë të ndryshme zemërimi, zhgënjimi dhe trishtimi. Mentorët

duhet të vendosin udhëzime dhe parametra për të lehtësuar bisedat e vështira dhe për të shprehur me respekt pikëpamjet e kundërta.³⁰

Maria është përfshirë në shumë aktivitete gjatë kësaj faze për arritjen e qëllimeve që ka vendosur së bashku me Suzanën. Bashkë me Suzanën, Maria hyri në një kurs për gjuhë të huaja, ku ka pasur mundësinë të përmirësonte aftësitë e saj gjuhësore dhe të socializohej me persona të tjerë. Gjatë kësaj kohe, ajo ka ndjekur edhe aktivitete sociale, ku ka praktikuar gjuhë të huaja dhe ka bërë shumë miq të rinj. Ajo ka krijuar edhe një grup social me të rinj të tjerë me të cilët flet rreth dëshirave dhe ideve se ku mund të gjejë mbështetje.

Ajo ka ndjekur edhe aktivitetet kishtare të cilat e mbushin me pozitivitet dhe optimizëm. Pak nga pak, ajo arriti të bënte paqe me të kaluarën dhe të shihte drejt së ardhmes..

Maria mbaroi me sukses shkollën e mesme dhe filloi punë në një dyqan lulesh. Suzana diskutonte për shumë kohë me Marian rreth shqetësimeve dhe ndjenjave të saj për ta ndihmuar atë të kontrollonte më mirë reagimet dhe emocionet.



Faza e katërt: Përfundimi i marrëdhënies formale të mentorimit dhe planifikimi për të ardhmen (1-2 muaj)

Mbyllja e marrëdhënies së mentorimit përfshin përgatitjen, si dhe diskutimin dhe reflektimin. Është e rëndësishme që i mentoruari të jetë plotësisht i vetëdijshëm për mbylljen e ardhshme të marrëdhënies dhe të ketë kohë për t'u përgatitur. I mentoruari mund të jetë fillimisht i mërzitur që marrëdhënia do të përfundojë dhe mentori do të duhet të dëgjojë dhe adresojë këto ndjenja. Në disa raste, menaxheri i rastit mund të duhet gjithashtu të përfshihet për të ndihmuar me këtë tranzicion.

Diskutimet në këtë fazë përqendrohen në:

- Arritjet dhe progresi drejt objektivave
- Sfidat e hasura në arritjen e këtyre synimeve
- Cilat sfida e presin përpara
- Plane pozitive për të ardhmen
- Llojet e tjera të mbështetjes që mund të kenë nevojë dhe si mund të kenë akses në këtë ndihmë
- Nëse marrëdhënia do të vazhdojë joformalisht dhe, nëse po, si
- Vlerësim për përvojën e mentorimit

Kjo fazë përfshin planifikimin për suksesin e në vazhdim të të mentoruarit, si dhe mbylljen e marrëdhënies formale të mentorimit. Kjo ndodh kur këto qëllime janë përmbushur dhe i mentoruari kapërfutur nga kjo marrëdhënie e shëndetshme dhe pranuese e mentorimit.

Në disa raste, marrëdhënia e mentorimit mund të përfundojë përpara se të realizohen qëllimet (për shembull, sepse i mentoruari zhvendoset për të jetuar diku tjetër ose mentori nuk është në gjendje të vazhdojë mentorimin. Megjithatë, duhet të ketë ende një fazë mbylljeje të marrëdhënies dhe pavarësisht nga sa kohë ka zgjatur marrëdhënia. Duhet të mbahen takime për të diskutuar mbylljen e marrëdhënies. Është e rëndësishme që i mentoruari të vazhdojë të ndihet i mbështetur dhe të minimizojë ndjenjat e braktisjes. Për shkak se marrëdhënia e mentorimit është një marrëdhënie e ngushtë dhe miqësore e ndërtuar mbi besimin, të

³⁰MENTOR and MHA-NYC (2009) *Supporting Young People in the Wake of Violence and Trauma*. Boston: MENTORI dhe Nju Jorku: Shoqata për Shëndetin Mendor, Nju Jork, f.4.

mentoruarit mund të kenë vështirësi kur përfundon, veçanërisht kur është më shpejt se sa ishte planifikuar për shkak të rrethanave të jashtme. I mentoruari mund të përjetojë një sërë reagimesh dhe ndjenjash duke përfshirë braktisjen dhe humbjen e një shoku, ndjenjat se marrëdhënia nuk ishte e rëndësishme për mentorin e tyre, që të gjithë largohen gjithmonë dhe se askush nuk kujdeset vërtet për ta.

Prandaj, në veçanti, kjo fazë kërkon profesionalizëm dhe kujdes në trajtimin e mbylljes së procesit të mentorimit dhe adresimin e shqetësimeve dhe ndjenjave të të mentoruarve. Çështjet kryesore që kërkojnë shpjegim dhe diskutim përfshijnë:

- Arsyet e përfundimit të marrëdhënies (qoftë kur është në kohë normale ose në rastet kur mbyllja është e parakohshme)
- Natyra e marrëdhënies pas mbylljes (d.m.th. marrëdhënia mund të vazhdojë por jo në mënyrëformale dhe me komunikim dhe ndërveprim të reduktuar)
- Arritjet e marrëdhënies së mentorimit dhe çfarë kanë mësuar i mentoruari dhe mentori në këtëkohë
- Si të ruhen dhe mobilizohen vlerat e nxjerra dhe mësimet e nxjerra gjatë mentorimit
- Si ta mbani mend dhe ta vlerësoni këtë marrëdhënie (për shembull, mbani një moment që i kujton të mentoruarit dhe mentorit periudhën e mentorimit)

Koha e nevojshme për të përpunuar dhe kaluar me sukses këtë fazë është e ndryshme për përfitues të ndryshëm. Është e rëndësishme t'i jepni të gjithëve kohën e nevojshme në mënyrë që kjo fazë të mos jetë e dëmshme.

Një vit pas mentorimit, Maria përfundoi me sukses shkollën e mesme dhe u përmirësua ndjeshëm me ndërveprimet sociale në shkollë dhe në mjedisin social në përgjithësi. Ajo i rivendosi sërish kontaktet me familjarët dhe vazhdon punën në një dyqan lulesh. Ajo vazhdon të ndjekë kursin për gjuhë të huaja dhe vijon të shkojë në kishë çdo të diel.

Duke parë këtë ecuri dhe sukses, u vendos se kishte ardhur koha që t'i jepej fund marrëdhënies mentoruese formale. Maria dhe Suzana filluan të diskutonin për përfundimin e punës mentoruese dhe se çfarë nënkuptonte kjo gjë. Ato organizuan edhe aktivitetet e fundit midis mentores dhe të mentoruarës, duke krijuar kështu kujtime dhe duke diskutuar se si mund ta mbajnë marrëdhënien midis tyre. Suzana ishte e gatshme ta mbante marrëdhënien me Marian dhe kjo e fundit ishte e gatshme ta përfundonte marrëdhënien, që përfshinte telefonatat dhe kthimin e mesazheve.

Maria tha se marrëdhënia mentoruese që kishte me Suzanën e ka ndihmuar shumë në rikuperim dhe e ka bërë të gatshme të ndajë shumë gjera të rëndësishme. Suzana ka qenë një person shumë i rëndësishëm në jetën e saj, gjatë një periudhe shumë të vështirë.

Sfidat që hasen në mentorimin e viktimave të trafikimit gjatë riintegritimit ³¹

Mentorimi ofron shumë përfitime dhe mundësi për viktimat e trafikimit gjatë rikuperimit dhe riintegritimit të tyre. Në të njëjtën kohë, marrëdhënia mentor/i mentoruar mund të jetë një marrëdhënie komplekse me shumë çështje potenciale. Sfidat me të cilat përballen mentorimi i viktimave të trafikimit gjatë riintegritimit përfshijnë:

- **Koha dhe energjia e kufizuar**
- **Çështje të besimit dhe sigurisë**
- **Kur nuk ka një përgjigje**
- **Të qenët të ndërgjegjshëm për ngjashmëritë dhe dallimet**
- **Sjelljet lënduese**
- **Bërja e kërkesave dhe vendosja e kufijve**
- **Rregulla të thyera**
- **Ndjenjat e inferioritetit**
- **Gjetja e aktiviteteve të duhura**
- **Ndjekja e planit**
- **Mentorimi - një model i ri**

Koha dhe energjia e kufizuar

Si mentorët ashtu edhe të mentoruarit mund të përballen me vështirësi në gjetjen e kohës së mjaftueshme për marrëdhënien e mentorimit. Edhe me qëllimet më të mira, prioritetet e tjera mund të ndërhyjnë si për mentorin ashtu edhe për të mentoruarin. Prandaj është e dobishme të qenit realist në fillim të marrëdhënies, madje edhe të "filloni pak nga pak" në mënyrë që premtimet dhe angazhimet të mund të përmbushen. Është gjithashtu e rëndësishme të komunikoni nëse koha dhe energjia që investohet në marrëdhënie është e mjaftueshme dhe e kënaqshme për të dyja palët.

Çështje të besimit dhe sigurisë

Me kohë të kufizuar së bashku, mentorët dhe të mentoruarit mund të hasin vështirësi për të ndërtuar nivelin e nevojshëm të besimit dhe rehatisë në marrëdhënien e tyre. Kjo është një situatë veçanërisht sfiduese për viktimat e trafikimit, të cilat kanë vështirësi t'u besojnë të tjerëve pas shfrytëzimit që kanë përjetuar. Thënë kjo, ka mënyra në të cilat mentorët, nëpërmjet sjelljeve dhe qëndrimeve të tyre, mund të demonstrojnë besueshmërinë e tyre ndaj të mentoruarve si mentorë të besueshëm dhe ngushëllues. Disa strategji të ndryshme përfshijnë:

³¹D&E dhe KMOP (2019) *Trajnim mbi mentorimin – Mbështetja e ish viktimave*. Tiranë: Të Ndryshëm dhe Të Barabartë, Athinë: Qendra për Veprim Social dhe Inovacion (KMOP).

- ✓ Dëgjoni në mënyrë aktive dhe me kujdes të mentoruarin gjatë gjithë komunikimit
- ✓ Mbani mend dhe mësoni ato që i mentoruari ka thënë dhe ndarë në të kaluarën
- ✓ Mbani premtimet dhe zotimet dhe jini të hapur dhe komunikues kur keni nevojë të riprogramoni ose bëni një ndryshim
- ✓ Pranoni kur bëhen gabime dhe nxirrni mësim nga përvoja.
- ✓ Shmangni të folurit negativisht për të tjerët
- ✓ Trajtojeni të gjithë informacionin e ndarë nga i mentoruari si konfidencial



Një sfidë e madhe në marrëdhënien mentor- i mentoruar janë pritshmëritë. Mentori dhe i mentoruari hyjnë në marrëdhënie me pritshmëritë për njëri-tjetrin dhe me pritshmëritë për marrëdhënien. Ndonjëherë pritshmëritë të bëjnë të kërkosh më shumë, të humbasësh durimin dhe të përqendrohesh në rezultatin e pritur. Ajo që kam mësuar më së miri është të pres dhe të eci me hapin e të mentoruarit, t'i japë kohë për të reflektuar, mësuar, shprehur dhe ndryshuar. Pritshmëritë gjithashtu duhet të jenë realiste, secili arrin atë që mundet. Çdo përpjekje dhe çdo arritje, sado e vogël qoftë, duhet përgëzuar. (Mentor)



Kur nuk ka një përgjigje

Shumë mentorë ndihen të pafuqishëm kur nuk i kanë të gjitha përgjigjet dhe zgjidhjet për situatat. Dëshira e tyre për të ndihmuar dhe mbështetur është ajo që i shtyn ata të bëhen mentorë.

Është e rëndësishme që mentorët të kujtojnë se roli i tyre nuk është të prodhojnë zgjidhje, por të punojnë për t'i ndihmuar të mentoruarit të gjejnë zgjidhje dhe opsione. Mentorëve mund t'u duhet t'u kujtojnë të mentoruarve se nuk do t'i kenë të gjitha zgjidhjet, por se do të mësojnë së bashku se si të trajtojnë disa çështje dhe kur është e nevojshme, mund të kërkojnë ndihmë nga të tjerët që janë më ekspertë në tema të ndryshme.



Gjithmonë kam pasur frikë të flas me të tjerët, e kam pasur të vështirë ta ndaj gjërat e mia. Por mësova ta bëja dhe u ndjeva shumë mirë. (E mentoruar)



Të qenit të ndërgjegjshëm për ngjashmëritë dhe dallimet

Të mentoruarit mund të kenë pasur përvoja të ndryshme nga mentorët. Përveç zbulimit të ngjashmërive, mentorët duhet të punojnë me kujdes për të identifikuar dallimet midis tyre dhe të mentoruarit. Kjo mund të përfshijë gjëra me të cilat i mentoruari është përballur në jetën e tij dhe që mentori jo. Mund të ketë edhe dallime për shkak të moshës, gjinisë, racës, kulturës, profesionit e kështu me radhë.

Sjelljet lënduese

Disa veprime ose sjellje nga mentorët mund ta bëjnë viktimën-të mentoruar të ndihet i refuzuar dhe i zhgënjyer. Kjo ndodh, për shembull, kur mentorët nuk janë të besueshëm dhe anullojnë takimet ose nuk i mbajnë premtimet që kanë bërë. Është e rëndësishme që mentorët të marrin në konsideratë dhe parashikojnë se cilat mund të jenë sjellje të dëmshme për të mentoruarit dhe t'i shmangni ato sa më shumë që të jetë e mundur ose adresojini/shpjegojini me të mentoruarin kur ato ndodhin.

Bërja e kërkesave dhe vendosja e kufijve

Të mentoruarit kërkojnë vëmendje dhe mbështetje. Në disa raste ata bëjnë kërkesa që janë jashtë takimeve dhe kohërave të dakorduara, kërkojnë ndërveprime shumë më të gjata ose kërkojnë ndihmë nga mentori që është jashtë qëllimit të marrëdhënies.

Ata gjithashtu mund të kërkojnë vëmendje të menjëhershme dhe urgjente. Zakonisht kjo sjellje bëhet për të testuar mentorin për sa i përket angazhimit të tyre për ta ndihmuar dhe mbështetur. Ndonjëherë vendosja e kufijve me përfituesit është sfiduese. Kur ky është një model konsistent i sjelljes, kjo duhet të trajtohet në bashkëpunim me menaxherin e rastit.



Kam pasur eksperiencën me të mentoruar shumë sfidues, ku njëkohësisht kanë pasur vështirësi për të krijuar dhe mbajtur një marrëdhënie të shëndetshme, por ajo që ka ndihmuar shumë në këto raste është menaxhimi duke vendosur objektiva realiste. (Mentor)



Rregulla të thyera

Mentorët duhet të vendosin rregulla dhe kufizime dhe të sigurojnë që të mentoruarit t'i respektojnë ato. Disa rregulla dhe kufizime vendosen së bashku me të mentoruarin. Respektimi i këtyre rregullave dhe parametrave është pjesë e një marrëdhënieje të fortë dhe të besueshme mentorimi. Mentorët duhet të sigurojnë respektimin e rregullave. Thyerja e rregullave krijon një marrëdhënie kaotike, ndërsa viktimat kanë nevojë për një marrëdhënie të qëndrueshme, të shëndetshme dhe të parashikueshme.

Ndjenjat e inferioritetit

Të mentoruarit mund të kenë ndjenja inferioriteti për shkak të historive të vështira ose aspekteve të tjera të jetës së tyre. Nga ana tjetër, mentorët janë përgjithësisht persona të suksesshëm dhe frymëzues, për të shërbyer si model. Ky ndryshim mund ta bëjë viktimën-të orientuar të ndihet inferior dhe në pozitë të pakëndshme. Mentorët duhet të jenë të vetëdijshëm për potencialin e këtyre ndjenjave dhe të parashikojnë se si të bëhen ndihmues për ti kaluar këto situata. Diçka që mund të ndikojë është pamja e dikujt (çfarë vesh) dhe se si dikush flet për jetën e përditshme. Bisedat rekomandohen të jenë në një kontekst të ngjashëm, duke shmangur diferencat dhe ndjesitë e pakëndshme.



Unë thjesht doja që dikush të më pranonte dhe të besonte versionin tim të historisë. Mentorja ime e bëri. (E mentoruar)



Gjetja e aktiviteteve të duhura

Përfituesit kanë interesa të ndryshme, diçka që i pëlqen dikujt, dikujt tjetër nuk i pëlqen. Ka përfitues që kanë pak interesa, janë më pak të motivuar dhe në këtë rast është më e vështirë të gesh llojin e aktivitetit që i përshtatet apo personin do e motivonte.

Ndjekja e planit

Ndonjëherë për shkak të angazhimeve ose rezistencës së përfituesve, nuk është gjithmonë e mundur të ndiqet axhenda ose të kryhen aktivitetet e planifikuara, dhe ndonjëherë edhe të mbahen kontakte me ta.

Mentorimi - një model i ri

Për shkak se roli i mentorit nuk njihet gjerësisht në Shqipëri, mund të ketë konfuzion nga ana e mentorëve dhe të mentoruarve për natyrën dhe kufijtë e marrëdhënies. Është gjithashtu një model i ri për institucionet shtetërore që mund të shkaktojë edhe konfuzion rreth punës. Ka udhëzues të limituar në dispozicion për mentorimin.

“

Çdo ditë e kaluar me të mentoruarit, çdo aktivitet lë gjurmë në kujtesë. I kam parë të gjitha të reflektuara dita ditës, kam parë gëzim, trishtim, emocione të përjetuara. Ishte e vështirë por shpërblyese.

(Mentor)

”

Çështjet kryesore në mentorimin e viktimave të trafikimit

Udhëzime për profesionistët

- Të qenit të informuar dhe të përgatitur.** Është e rëndësishme që mentorët të kuptojnë vërtet procesin e mentorimit dhe të gjithë hapat në procesin e mentorimit. Profesionistët duhet të marrin kohë për të përcjellë të gjithë informacionin e kërkuar nga mentorët përpara se të marrin një vendim nëse do të bëhen mentorë.
- Zgjedhja me kujdes e mentorëve.** Duke pasur parasysh rëndësinë e mentorit në rikuperimin dhe riintegrimin e të mentoruarit, profesionistët duhet të sigurojnë që çdo mentor të jetë në gjendje të përmbushë rolet dhe përgjegjësitë përpara se të zgjidhet si i tillë. Mentorët duhet të jenë plotësisht të përfshirë dhe të përkushtuar ndaj rolit të tyre, duke mbajtur kontakte dhe marrëdhënie të rregullta me të mentoruarin me kalimin e kohës. Mentorët duhet të jenë gjithmonë në kohë për takime dhe aktivitete dhe gjithmonë të mbajnë premtimet dhe angazhimet e tyre.
- Përgatitja dhe trajnimi i mentorëve dhe të mentoruarve.** Pasi të zgjidhen dhe të verifikohen, mentorët duhet të trajnohen për t'i mundësuar ata të kryejnë rolin e tyre në mënyrë efektive dhe të sigurt për të mbështetur të mentoruarit ndërsa marrëdhënia përparon, me mbështetje dhe mbikëqyrje të mëtejshme të ofruar sipas nevojës. Është e rëndësishme t'i jepet përparësi përgatitjes dhe trajnimit të mentorëve përpara se ata të ndërveprojnë me të mentoruarit. Siguroni trajnime të vazhdueshme dhe të rregullta, mentorim dhe supervizim përgjatë procesit të mentorimit. Të mentoruarit duhet gjithashtu të përgatiten në mënyrë adekuate për marrëdhënien e mentorimit dhe të informohen plotësisht për atë që ajo përfshin.
- Menaxhimi i marrëdhënies mentor - i mentoruar.** Mentorët luajnë një rol të rëndësishëm në jetën e viktimës - të mentoruar. Një marrëdhënie mentorimi duhet të jetë një marrëdhënie mbështetëse, e dobishme dhe pozitive. Kur lindin pengesa dhe çështje të ndryshme, mentorët duhet të jenë të gatshëm të punojnë me këto pengesa dhe të përpiqen të ndërtojnë një marrëdhënie të besueshme dhe të shëndetshme.
- Të punuarit së bashku në procesin e mentorimit.** Profesionistët dhe mentorët duhet të njihen mirë me sfidat e ndryshme në punën me viktimat e mentoruara, për të qenë në gjendje t'i zgjidhin dhe të përballen me këto sfida. Është e rëndësishme që profesionistët dhe mentorët të punojnë së bashku në mbështetjen e rikuperimit dhe riintegrimin të viktimës-të mentoruar.
- Fokusi në natyrën e marrëdhënies së mentorimit.** E rëndësishme në mentorim është marrëdhënia mbështetëse, e respektueshme dhe e besueshme. Është e rëndësishme që një viktimë-e mentoruar të dijë se mentori i tyre i mbështet dhe i pranon dhe është i disponueshëm për ta. Viktimat-të mentoruarit duhet të jenë të sigurt se marrëdhënia e mentorimit do të zgjasë për aq kohë sa u nevojitet.

✓ **Të qenit fleksibël dhe të adaptueshëm.** Çdo marrëdhënie mentorimi është unike. Praktikuesit dhe mentorët do të duhet të jenë fleksibël dhe të adaptueshëm në punën me secilën viktimë-të mentoruar dhe të zhvillojnë marrëdhënien dhe procesin më mbështetës dhe pozitiv të mentorimit.

✓ **Sigurimi i standardeve më të larta etike.** Mentorët duhet t'u përmbahen standardeve më të larta etike dhe profesionale në punën me viktimën-të mentoruarin. Është e rëndësishme që mentorët të jenë të informuar dhe të qartë rrethparimeve dhe praktikës etike. Profesionistët luajnë një rol të rëndësishëm për të siguruar që ky është rasti.

Marrja parasysh e sfidave dhe si të kapërcehen ato. Mentorimi ofron shumë përfitime dhe mundësi për viktimat e trafikimit gjatë rikuperimit dhe riintegrit të tyre. Në të njëjtën

✓ kohë, marrëdhënia mentor/i mentoruar mund të jetë një marrëdhënie komplekse që mund të ketë çështje e probleme të ndryshme. Mentorët duhet të jenë të vetëdijshëm për gamën e sfidave me të cilat mund të përballen në mentorimin e viktimave të trafikimit gjatë riintegrit dhe të zhvillojnë strategji për tejkalimin e këtyre sfidave. Profesionistët e riintegrit duhet të mbështesin mentorët në menaxhimin e sfidave dhe problemeve.

✓ **Të kuptuarit dhe përgatitja për procesin e plotë të mentorimit.** Mentorimi zakonisht zgjat rreth një vit. Mentorët duhet të jenë të vetëdijshëm për katër fazat kryesore të marrëdhënies së mentorimit dhe të jenë të përgatitur që t'i kushtojnë kohë dhe energji të mjaftueshme mentorimit për kohëzgjatjen e plotë të kërkuar.

Shtojcat

Shtojca #1. Fjalorthi i termave

Shtojca #2: Studime dhe burime mbi riintegrimin nga D&E dhe Instituti NEXUS

Shtojca #1. Fjalorthi i termave

| Termi | Përkufizimi |
|--|---|
| Asistencë | Masa vullnetare, programe dhe shërbime që synojnë rikuperimin e personave të trafikuar, të ofruara nga shteti, organizata jofitimprurëse (OJF), dhe organizata ndërkombëtare (IOs), në vendet e destinacionit, tranzitit dhe origjinës. Asistenca mund të jetë specifike për trafikimin ose në forma më të përgjithshme të asistencës, të ofruar si pjesë e shërbimeve shtetërore të përgjithshme, si sistemet e mbrojtjes së fëmijës ose shërbimet për personat e cenueshëm në aspektin social. Asistenca mund të përfshijë, por nuk kufizohet vetëm në: akomodimin/strehimin, kujdesin mjekësor, asistencën psikologjike, arsimin, formimin profesional, aftësitë jetësore, punësimin dhe fuqizimin ekonomik, asistencën ligjore, transportin, dhe ndërmjetësimin/këshillimin familjar. |
| Qasje miqësore me fëmijën | Hartimi dhe zbatimi i masave duke pasur parasysh nevojat, interesat, sigurinë dhe interesat më të larta të fëmijës |
| Qasje e përshtatshme në aspektin kulturor | Marrja në konsideratë dhe respektimi i besimeve kulturore dhe fetare, vlerat, normat, praktikat dhe gjuhën e viktimës |
| Qasje me ndjeshmëri gjinore | Trajtimi i të gjitha viktimave me të njëjtin respekt, pavarësisht identitetit të tyre gjinor, duke shmangur stereotipet ose supozimet mbi baza gjinore |
| Identifikim | Identifikimi është procesi në të cilin individi identifikohet si viktimë e trafikimit ose viktimë e mundshme e trafikimit. Identifikimi formal është procesi ose vendimi që rezulton në një vendim shtetëror zyrtar se një person është viktimë e trafikimit, ndërsa identifikimi joformal është procesi ose vendimi që rezulton në faktin që një person konsiderohet viktimë e trafikimit jashtë procesit të identifikimit formal të shtetit. |
| Viktimë e prezumuar (ose e mundshme) e trafikimit | Personi që është konsideruar dhe identifikuar si viktimë e trafikimit, por që formalisht nuk është identifikuar si e tillë. |
| Mbrojtje | Një nga tre P-të (Protection) të përgjigjes kundër trafikimit, synon mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Në përgjithësi, përfshin procesin e identifikimit, referimit, dhe asistencë, duke përfshirë riintegrimin. Gjithashtu, i referohet rolit të çdo qeverie për të ndërmarrë hapa afirmativë për të vlerësuar rreziqet dhe për të garantuar sigurinë e çdo viktime. |

| | |
|--------------------------------------|--|
| Riintegrim | Procesi i rikuperimit dhe përfshirjes ekonomike dhe sociale pas një përvoje trafikimi. Ai përfshin: sistemimin në një mjedis të sigurt dhe të siguruar; aksesin në një jetese standarde të arsyeshme; mirëqenien mendore dhe fizike; mundësitë për zhvillim personal, social dhe ekonomik; dhe aksesin në mbështetje sociale dhe emocionale. Riintegrimi mund të përfshijë kthimin në familjen dhe/ose komunitetin e origjinës së viktimës, integrimin në një komunitet të ri, ose integrimin në një shtet të ri në varësi të nevojave dhe interesave specifike të individit. Riintegrimi ndodh në nivele të ndryshme: në nivel individual, në mjedisin familjar, në komunitetin e gjerë dhe në shoqërinë formale. ³² |
| Qasja e informuar mbi traumen | Njohja e ndikimit të traumës dhe promovimi i mjediseve të shërimit dhe rikuperimit |
| Qasja me në qendër viktimën | Prioritizimi i dëshirave, sigurisë dhe mirëqenies së viktimës në të gjitha çështjet dhe procedurat |
| Trafikim i personave (TiP) | Rekrutimi, transportimi, transferimi, strehimi ose marrja e personave, me anë të kërcënimit ose përdorimit të forcës ose formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, abuzimit të pushtetit ose të një pozicioni të pambrojtur ose të dhënien ose marrjen e pagesave ose përfitimeve për të arritur pëlqimin e një personi që ka kontroll mbi një person tjetër, për qëllime shfrytëzimi; shfrytëzimi do të përfshijë, të paktën, shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose forma të tjera të shfrytëzimit seksual, punën ose shërbimet e detyruara, skllavërinë ose praktika të ngjashme me skllavërinë, robërinë ose heqjes së organeve. ³³ |
| Viktimë trafikimi (VT) | Personi që ka përjetuar dhe/ose përjeton sjellje të përcaktuara në nenin 3 të <i>Protokollit të Kombeve të Bashkuara për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve (Protokolli i Trafikimit)</i> ose në legjislacionin përkatës vendas. |

³² R. Surtees (2008) *Ri/integrimi i personave të trafikuar: si mund të jetë puna jonë më efektive?* Uashington D.C.: Instituti NEXUS dhe Bruksel: Fondacioni i Mbretit Baudouin, f. 11.

³³ Kombet e Bashkuara (2002) *Protokolli për parandalimin, shtypjen dhe ndëshkimin e trafikimit të personave, veçanërisht të grave dhe fëmijëve*. Kombet e Bashkuara.

Shtojca #2: Studime dhe burime mbi riintegrimin nga D&E dhe Instituti NEXUS

Brunovskis, A. & R. Surtees (2012) *A fuller picture. Addressing assistance needs and vulnerabilities*. Oslo: Fafo & Washington: NEXUS Institute. Available at:

https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/no-place-like-home_familyreintegration_nexus.pdf

Brunovskis, A. & R. Surtees (2012) 'Coming home. Challenges in family reintegration', *Qualitative Social Work*. Available at: <https://journals.sagepub.com/doi/pdf/10.1177/1473325011435257>

Brunovskis, A. & R. Surtees (2012) *No place like home? Challenges in family reintegration*. Oslo: Fafo & Washington, D.C.: NEXUS Institute. Available at:

https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/no-place-like-home_familyreintegration_nexus.pdf

Brunovskis, A. & R. Surtees (2008) 'Agency or illness. The conceptualization of trafficking victims' choices and behaviours in the assistance system', *Gender technology and development*. Available at:

<https://www.tandfonline.com/doi/pdf/10.1177/097185240701200105?needAccess=true>

Brunovskis, A. & R. Surtees (2007) *Leaving the past behind. When trafficking victims decline assistance*. Oslo: Fafo & Washington, D.C.: NEXUS Institute. Available at:

<https://nexusinstitute.net/publications/assistance-and-reintegration-of-trafficking-victims/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2021) *Mbrojtja e fëmijëve nga trafikimi dhe shfrytëzimi; Udhëzues për Punonjësit e Mbrojtjes së Fëmijës*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë.

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2020) *Manual për menaxhimin e rasteve të viktimave të trafikimit në Shqipëri*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:

http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2021/07/CASE-MANAGEMENT-MANUAL-DE_compressed.pdf

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2019) *Shtëpia e Gjyshes ose Shtëpia Tjetër*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:

http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2020/05/E-fundit-Shtepia-e-gjyshes-ose-shtepia-tjeter_libri_shqip_Ok.pdf

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2019) *Studim mbi nevojat dhe mundësitë që ofron tregu i punës për të mbështetur fuqizimin ekonomik të të mbijetuarave të trafikimit dhe dhunës në familje në Tiranë, Kukës, Dibër dhe Sarandë*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:

<http://differentandequal.org/sq/studimi-mbi-tregun-e-punes/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2019) *Standardet e Shërbimit të Njësive Lëvizëse për Identifikimin dhe Referimin e viktimave /viktimave të mundshme të trafikimit*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:

<http://differentandequal.org/sq/standardet-e-sherbimit-te-njesive-levizese-per-identifikimin-dhe-referimin-e-viktimave-viktimave-te-mundshme-te-trafikimit/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2015) *Të lënë pas dore! Trafikimi i burrave dhe djemve në Shqipëri*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në:

<http://differentandequal.org/wp-content/uploads/2018/12/Te-lene-pas-dore-1.pdf>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2009) *Studimi mbi Riintegrimin Social-Ekonomik të Viktimave të Trafikimit në Shqipëri*. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në: <http://differentandequal.org/sq/studimi-mbi-riintegrimin-social-ekonomik-te-viktimave-te-trafikimit-ne-shqiperi/>

Të Ndryshëm & Të Barabartë (2009) Raporti Vjetor i organizatës “Të Ndryshëm & Të Barabartë”. Tirana, Shqipëri: Të Ndryshëm & Të Barabartë. E disponueshme në: <http://differentandequal.org/en/raporti-vjetor-2009/>

Surtees, R. (2019) ‘Feeling a failure: Returning home a ‘Trafficked man’ in Indonesia’, *openDemocracy*. Available at: <https://www.opendemocracy.net/en/beyond-trafficking-and-slavery/feeling-a-failure-returning-home-a-trafficked-man-in-indonesia/>

Surtees, R. (2018) ‘At home. Family reintegration of trafficked Indonesian males’, *Antitrafficking review*. No. 10. Available at: www.antitraffickingreview.org/index.php/atrjournal/article/view/322

Surtees, R. (2017) ‘Being Home. Exploring Family Reintegration Among Trafficked Indonesian Domestic Workers’. In R. Piotrowicz, C. Rijken and B. Heide Uhl (Eds.) *Routledge Handbook on Human Trafficking*. Routledge. Available at: <https://www.routledge.com/RoutledgeHandbook-of-Human-Trafficking/Piotrowicz-Rijken-Uhl/p/book/9781138892064>

Surtees, R. (2017) *Moving on. Family & community reintegration among Indonesian trafficking victims*. Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2020/02/moving-on-nexus-institute-2017.pdf>

Surtees, R. (2017) *Our Lives. Vulnerability & resilience among Indonesian trafficking victims*. Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2020/02/our-lives-nexus-institute-2017.pdf>

Surtees, R. (2017) *Supporting the reintegration of trafficked persons. A Guidebook for the Greater Mekong Sub-Region*. Bangkok, Thailand: NEXUS Institute, UN-ACT and World Vision. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2017/04/final-reintegration-guidebook-gms.pdf>

Surtees, R. (2017) ‘Declining assistance. Understanding trafficked persons’ decisions, choices and resiliency’. In A. Aronwitz (Ed) *Human trafficking: A Reference Handbook*. ABC-CLIO. Available at: <https://www.amazon.com/Human-Trafficking-Reference-HandbookContemporary-ebook/dp/B01N9XAFJH>

Surtees, R. (2016) ‘What’s home? (Re)integrating children born of trafficking’, *Women & Therapy Journal*. 40 (1-2): 73-100. Available at: <https://www.tandfonline.com/eprint/Z5HzV2AZAZnqmxCyBi4/full>

Surtees, R. (2015) *Beyond trafficking. The re/integration of trafficking victims in the Balkans, 2007 to 2014*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/06/beyond-trafficking-final-report.pdf>

Surtees, R. (2014) *Reintegration of trafficked persons. Trafficked children & youth*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/pub_3268_reintegrationoftraffickedchildren.pdf

Surtees, R. (2013) *Ethical principles in the reintegration of trafficked persons*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/02/ethical-principles-for-the-reintegrationof-trafficked-persons.pdf>

Surtees, R. (2013) *After trafficking. Experiences and challenges in the (re)integration of trafficked persons in the GMS*. Bangkok and Washington: UNIAP& NEXUS Institute. Available at: https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/aftertrafficking_experiences-and-challenges-in-reintegration-in-the-gms.pdf

Surtees, R. (2012) *Reintegration of trafficked persons. Economic empowerment*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/nexus_economic-empowerment.pdf

Surtees, R. (2010) *Monitoring anti-trafficking re/integration programmes. A manual*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/monitoring-at-reintegrationprogrammes_manual_nexus.pdf

Surtees, R. (2008) *Reintegration of trafficked persons. Handling “difficult” cases*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/reintegration-of-trafficked-personshandling-difficult-cases.pdf>

Surtees, R. (2008) *Reintegration of trafficked persons. How to be more effective*. Brussels: KBF & Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/reintegration-of-trafficked-persons-howcan-our-work-be-more-effective.pdf>

Surtees, R. (2008) ‘Trafficked men and unwilling victims’, *St. Antony’s International Review*, 4(1), pp. 16-36. Available at: <https://www.ingentaconnect.com/content/stair/stair/2008/00000004/00000001/art00003>

Surtees, R. (2017) *Listening to victims: Experiences of identification, return and assistance in SE Europe*. Vienna: ICMPD & NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/listening-to-victims.pdf>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Trafficking Victim Identification: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Trafficking Victim Protection and Support: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Recovery and Reintegration of Trafficking Victims: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>

Surtees, R. & L.S. Johnson (2021) *Special and Additional Measures for Child Trafficking Victims: A Practitioner Guide*. Washington D.C.: NEXUS Institute & Bangkok: Regional Support Office

of the Bali Process. Available at: <https://nexusinstitute.net/past-projects/practitionerguideseries/>

Surtees, R. & F. de Kerchove (2014) 'Who funds reintegration? Sustainable services for VoTs', *AntiTrafficking Review*. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2015/03/whofunds-reintegration.pdf>

Surtees, R., Johnson, L.S., Zulfahary, T & S. DaengCaya (2016) *Going home. Challenges in the reintegration of trafficked persons in Indonesia*. Washington D.C.: NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2017/09/going-home-english-final.pdf>

Surtees, R. & S. Somach (2008) *Methods and models of mixing services for victims of domestic violence and trafficking in persons*. Washington D.C.: USAID, Creative Associates International, Inc., and the Aguirre Division of JBS International, Inc. and the NEXUS Institute. Available at: <https://nexushumantrafficking.files.wordpress.com/2019/01/methods-and-models-for-mixing-services-for-victims-of-domestic-violence-and-trafficking-in-persons.pdf>